



Editorial



Reformimi i shoqërisë

“Mesi i vitit 2005 po afrohet,” tërheq vëmendjen Marc Grossmann, zëvendës-sekretari i shtetit të SHBA-ve gjatë vizitës së tij në Prishtinë. Ai tërhoqi vëmendjen në datën e shqyrtimit të zbatimit të Standardeve, që është lansuar edhe gjatë vizitave të tij të mëherëshme dhe konsultimet vijuese me të gjitha vendet e Grupit të Kontaktit. Nëse shqyrtimi i standardeve do të jetë pozitiv atëherë “mesi i vitit 2005” do të shënojë fillimin e shumëpritur të negociatave për statusin final të Kosovës.

Plani për Zbatimin e Standardeve është një dokument gjithëpërfshirës me 120 faqe që detajisht spjegojnë mënyrat e reformimit të shoqërisë. Është publikuar më 31 mars 2004 nga I Dërguari i atëherëshëm special për Kosovën Holkeri, dhe Kryeministri Rregjepi. Tetë standardet nënkuptojnë: funksionimin e institucioneve demokratike, sundimin e ligjit, lirinë e lëvizjes, kthimin dhe të drejtat e komuniteteve, ekonominë, të drejtat mbi pasuritë dhe trashëgimitë kulturore, dialogun dhe TMK-n.

Edhe pse kërkesa iu është drejtuar Kosovës dhe institucioneve të saja të bëjnë përparimet në Standarde, bashkësia ndërkombtare ka një rol esencial për të luajtur në procesin e zbatimit të standardeve, qoftë përmes sigurimit të resurseve, ngritjes së kapaciteteve dhe këshillimit, apo përmes ushtrimit të kompetencave ekzekutive në lëmitë e rezervuara që kanë të bëjnë me Standardet. Duke punuar bashkarisht – institucionet kosovare dhe bashkësia ndërkombtare – Kosova mund të bëhet shumë shpejt vend për një jetë më të mirë. Dhe rezultati do të jetë I përbashkët : qoftë ai sukses apo dështim.

Kur lexohet planin për Zbatimin e Standardeve, është për tu habitur sa konkrete dhe të qarta janë objektivat. Ja vetëm disa shembuj: pjesëmarrja e shtuar e bashkësive etnike në shërbimin civil posaqërisht në pozita të larta – p.sh programe të zgjeruara për plotësimin e vendeve të reja të punës (p. 12), Rregullat e punës së Kuvendit mundësojnë kohën e caktuar për debate/pyetje për të shqyrtuar punën e ministrave (p. 13), startohet me botimin e Gazetës Zyrtare, të gjitha vendimet ligjore të IPVQ-ve dhe udhëzimet administrative do të jenë të publikuara në Gazetë në të gjitha gjuhët zyrtare (p. 14), Komisioni Parlamentar për Buxhet parasheh shpenzimet publike në ministri dhe në të gjitha organizatat buxhetore (p. 19), zhvillimi i strategjisë për shpërbërjen e strukturave paralele dhe integrimin e tyre në strukturat e IPVQ-s (p. 21), miratimi i ligjit mbi mbrojtjen

dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore (p. 100), etj.

Këta janë vetëm disa nga shembujt që nënkuptohen në tetë Standardet. Është e qartë që Plani për Zbatim, ngërthen në vete një spektër të gjerë lëmesh të cilat shoqërohen me veprime konkrete, të matshme dhe të mundshme. Dhe kjo kërkon reformimin e shoqërisë. Ofron perspektivën e përmirësimit thelbësor të cilësisë së jetës në Kosovë. Por përsëri ngelet të jetë një proces kompleks me shumë pengesa që kryesisht lidhen me resurset njerëzore, vëmendjen e opinionit publik dhe kompetencat e ndara apo të rezervuara. Disa politikanë mendojnë që politika e ‘standardeve para statusit’ është përcaktuar me qëllim të shmangies së diskutimit mbi statusin. Disa mendojnë që IPVQ-të nuk mund të jenë përgjegjëse për mungesën e suksesit në lëmitë që kontrollohen nga UNMIK-u. Plani për Zbatimin e Standardeve është përpiluar bashkërisht nga zyrtarë kosovarë dhe ndërkombtarë, në pesë grupe punuese gjatë më shumë se katër muajve, me qëllim të qartësisë së roleve dhe përgjegjësisë të secilit. Mesi i vitit 2005 -data e shqyrtimit- ka bërë shumë analistë dhe politikanë të shfrytëzojnë kohën në mënyrë më konstruktive për të konsoliduar pozitë më të mirë para diskutimeve për statutin final të Kosovës, dhe përshpejtimin e transformimit të shoqërisë.

Nevoja për transformimin e shoqërisë kosovare është bërë temë e shumë diskutimeve. Gjatë konferencës së fundit në Partinë Turke të Kosovës, respektimi i gjuhëve ishte kërkesa kryesore e përkrahur nga pjesëmarrësitë e IPVQ-ve. Pak më parë, këshilltarët politikë të ministrave ishin në një vizitë pune në Vienë, për të shqyrtuar rolin e tyre në krijimin e politikave. Dhe pamë sesi implementimi i standardeve është bërë prizma përmes së cilës shikohet Kosova.

Për shkak të vëmendjes që zënë Standardet në proceset e tanishme politike dhe ekzistimit të mendimeve të ndryshme, ne kërkuam nga anëtarët e Kuvendit, Zyra e Kryeministrit dhe bashkëbiseduesëtë tjerë, të japin mendimet e tyre mbi sfidat komplekse që i presin në të ardhmën. Dhe ky numër i buletinit të ASI-t ofron disa këndvështrime të cilat shpresojmë se do të jenë interesante për ju.

Dhe pasi që Kuvendi po finalizon punën e vet para pushimeve verore, ne kërkuam nga professor Daci të bëjë analizën e punës së bërë në Kuvend gjatë këtij viti por edhe gjatë tërë mandatit të këtij kuvendit. Organizata të ndryshme partnerë të ASI-t japin informacione mbi aktivitetet e tyre për të mbështetur punën e Kuvendit: NDI elaboron rezultatet e anketimeve mbi funksionimin e komisioneve parlamentare, UNDP njohton për qendrën e parë informative të qeversjes parlamentare, Fondacioni Friedrich Ebert jep pasqyrën mbi seminarit të përbashkët të organizuar me OSBE në mbi rolin e këshilltarëve politikë të ministrave dhe marrëdhëniet e tyre me Kuvendin.

*Franklin De Vrieze,
Kordinator i Iniciativës për Mbështetjen e Kuvendit.*

PSSP i ri "do ta fillojë punën pa humbur kohë" në mes të gushtit


Nga David Buerstede, OSBE

Kosova është duke pritur PSSP-në e ri për të marrë postin e tij pasi që Sekretari i Përgjithshëm i KB-ve Kofi Anan informoi Këshillin e Sigurimit të KB-ve në mesin e qershorit për emërimin e Seren Jesen-Petersenit nga Danimarka si përfaqësues të tij të ri Special për Kosovën dhe si kryesues të UNMIK-ut. Disa komentatorë janë duke humbur durimin pse duhet aq shumë kohë për ardhjen e PSSP-së së ri.

Arsyeja kryesore është që z. Jesen-Petersen i kanë ngelur akoma disa punë të papërfunduara nga detyra e tij aktuale si Përfaqësues Special i Bashkimit Evropian në Shkup. Atje ai e ka dhënë kontributin e tij në përshejtimin e implementimit të Marrëveshjes së Ohrit, e cila i ridefinon në mënyrë institucionale raportet ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve në IRJM dhe njëherazi garanton zbatimin e të drejtave të pakicave dhe të drejtave të njeriut. Ai nuk mund thjeshtë të largohet pa i përmblyllur të paktën disa çështje. Një nga këto çështje është edhe plani për decentralizimin- një çështje që do të luaj rol shumë të rëndësishëm në Kosovë gjatë muajve në vijim.

Afër mendsh që para arritjes në Prishtinë, PSSP i ri duhet të informohet mirë mbi gjendjen në Kosovë. Ndonëse, z. Jasen-Petersen mund të mbështetet në përvojën e tij në të kaluarën në Evropën Juglindore, ai megjithatë duhet që shpejt e shpejt të njoftohet lidhur me çështje të veçanta për Kosovën.

Aktualisht z. Jasen-Petersen është duke kryer dy punë njëkohësisht. Aty nga mesi i gushtit, çështjet e Kosovës do të fillojnë t'i marrin çdo herë e më shumë



PSSP i sapoemëruar Søren Jesen-Petersen

kohë. Së këndejmi, përmes përgatitjeve të mirëfillëta PSSP i ri synon që "ta fillojë punën pa humbur kohë", duke qenë efikas që nga fillimi.

Një fillim i ri paraqet edhe mundësi të reja për krijimin e raporteve të afërta të pandikuara dhe të paprishura nga gabimet që kanë mundur të ndodhin në të kaluarën. Si PSSP ashtu edhe përfaqësuesit e IPVQ-ve dhe shoqërisë civile duhet të jenë të hapur ndaj njëri tjetrit dhe duhet të përpiqen të krijojnë raporte të mira që nga fillimi.

Në këtë kontekst, ish-PSSP Hari Hollkeri ishte një shembull i mirë. Një nga hapat e parë që ai i ndërmoi, me rastin e emërimit të tij në këtë post, ishte adresimi Kuvendit gjatë seancës plenare dhe oferta Kuvendit dhe IPVQ-ve për një bashkëpunim më të denjë. Ndaj është më se e qartë se ia vlen të ndiqet ky shembull, ngase i ofron Kuvendit mundësinë e një njohjeje më të mirë të PSSP-së së ri dhe pikëpamjeve të tij për Kosovën.

Shënim biografik për Soren Jesen-Petersen

Z. Jesen-Petersen ka shërbyer si Përfaqësues Special i BE-së në Shkup që nga 1 shkurti 2004. Njëkohësisht ka shërbyer si Kryesues i Iniciativës Rajonale të Paktit të Stabilitetit për Migracion, Azil dhe Refugjatë (MARRI). Në këtë detyrë ai ka iniciuar, hartuar dhe udhëhequr një strategji për menaxhimin e lëvizjeve të popullësisë në Ballkanin Perëndimor dhe një program të masave që mbulojnë çështjet e migracionit, azilit, kontrollit kufitar, vizave, kthimit të refugjatëve dhe vendbanimeve.

Z. Jesen-Petersen ka shërbyer si Ndhmës Komisioneri i Lartë në selinë e UNHCR-së në Gjenevë nga janari 1998 deri në dhjetor 2001. Ky është posti i tretë më i lartë në UNHCR. Në këtë detyrë z. Jesen-Petersen kryesoi të gjitha operacionet e UNHCR-së në botë dhe kreu rreth 80 misione në të gjitha rajonet e botës, të cilat kishin për

qëllim zhvillimin e strategjive operationale si dhe mobilizimin e përkrahjes qeveritare për aktivitetet e UNHCR-së.

Para emërimit të tij të fundit në Gjenevë, z. Jesen-Petersen shërbeu si Drejtor i Zyrës Ndërlidhëse të UNHCR-së në New York, nga 1 gushti 1994 deri më 9 janar 1998. Në këtë detyrë ai ishte zyrtar ndërlidhës i Komisionerit të Lartë me Zyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të KB-ve si dhe me departamentet tjera të KB-ve. Gjatë kësaj detyre ai pati kënaqësinë që t'i drejtohej disa herë Këshillit të Sigurimit.

Z. Jesen-Petersen shërbeu si i Dërguar i Posaçëm i Komisionerit të Lartë për ish Jugosllavinë nga dhjetori 1995 deri në shtator 1996 (me seli në Sarajevë), ku ishte përgjegjës për hartimin e strategjisë për mbikëqyrjen e implementimit të Shtojcës VII të Marrëveshjes së Paqes së Dejtonit dhe drejtoi një operacion humanitar në vlerë prej 350 milionë \$ për rreth 4 milionë refugjatë, persona të zhvendosur dhe viktimat tjera si dhe menaxhimin e më se 500 punëtorëve të UNHCR-së.

Në mes viteve 1990 dhe 1993, z. Jesen-Petersen shërbeu si Shef i Kabinetit të Komisionerit të Lartë në selinë e UNHCR-së në Gjenevë. Ai ishte këshilltari kryesor politik dhe diplomatik i Komisionerit të Lartë.

Më 1998 ai shërbeu, i deleguar prej UNHCR-së, si Këshilltar Special i Nën-Sekretarit të Përgjithshëm për Çështje Politike dhe si anëtar i Dërgatës së Sekretarit të Përgjithshëm në procesin drejt pavarësisë së Namibisë.

Më 1986, z. Jesen-Petersen shërbeu si Përfaqësues Rajonal i Sekretarit të Përgjithshëm për shtetet skandinave - Danimarkën, Finlandën, Islandën, Norvegjinë dhe Suedinë, deri në vitin 1989.

Z. Jesen-Petersen, shtetas danez, me profesion është jurist dhe gazetar dhe ka një sërë botimesh. Është i martuar dhe ka katër fëmijë.

"Shpresoj në një partneritet të vërtetë"

Intervistë me prof. Dacin, Kryetarë i Kuvendit të Kosovës për punën e që bëhet në Kuvend, për OKB-në dhe marrëdhëniet me pakicat.

Intervistoi: Doina Ghimici dhe David Buerstede, OSBE

ASI: Profesor Daci, ka kaluar një vit që nga intervista juaj e fundit për Buletinin e ASI-it. Ishte një vit në të cilin ishin të pranishme trende pozitive edhe negative në Kosovë. Gjatë kësaj kohe, vetë Kuvendi përjetoi "momente për çdo lavdatë" dhe arsye për kritikë. Sipas mendimit tuaj cilat janë të arriturat kryesore të Kuvendit dhe ku dështoi legjislatura kosovare në arritjen e parashikimeve?

Rezultatet më të mira të Kuvendit gjatë kësaj kohe ndërlidhen me numrin e ligjeve të përpunuara. E di që në media aktivitetet tona kritikohen por kjo zakonisht vë nga persona që asnjëherë nuk kanë qenë në parlamentet tjera të Evropës dhe mbështeten në gazeta si burim i vetëm i informacionit. Në shtetet evropiane duhen tre deri pesë muaj për përpunimin e një projektligji nga ana e parlamentit. Koha më e gjatë e cila na u nevojiti për miratimin e një ligji ishte pesë javë. Në Kuvendin e tanishëm duhet të arrijmë një balancim të numrit të ligjeve të miratuara në një anë, duke pasur parasysh që Kosova nuk ka ligje, dhe cilësisë së ligjeve në anën tjetër. Një e arritur tjetër e rëndësishme e Kuvendit të tanishëm është krijimi i mjedisit të qëndrueshëm politik, e cila zgjati deri në krizën e marsit. Parlamentit është zakonisht një vend ku ndodhin diskutime të gjalla dhe ku shpesh ngritet temperatura. Duke pasur parasysh që në Parlamentin tonë ekzistojnë shtatë grupe të partive të pakicave, kam punuar në krijimin e një atmosfere të këndshme për debate. Ndihej krenar që shpesh i'a kam arritur ti zbus tensionet në mes të deputetëve



Prof. Nexhat Daci, Kryetar i Kuvendit të Kosovës

shqiptarëve dhe të Koalicionit Kthimi. Për këtë jam kritikuar dhe jam akuzuar për ndaljen e demokracisë por kam sjellur vendimin që paqja dhe stabiliteti i Kosovës ishin më të rëndësishme. Ata që kritikojnë duhet ta kenë parasysh që pas 15 vitesh ky është Parlamenti i parë i njohur ndërkombëtarisht dhe se që të gjithë duhet të punojmë bashkarisht. Parlamenti ka përkrahje të madhe nga këshilltarët e bashkësisë ndërkombëtare, posaçërisht nga NDI-ja, Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe shumë fondacione tjera.

ASI: Cilat janë pikat e dobëta?

Ka shumë pika të dobëta. Pika

jonë më e dobët ishte që nuk ia dolëm që të përshpejtojmë programet sociale dhe të krijojmë sisteme përkatëse të sigurimit social për shoqërinë tonë. Për tri vite kemi pasur një rritje fare të vogël të rrogave për institucionet, arsimin dhe shëndetësinë. Nuk ia dolëm të gjejmë asnjë zgjidhje për problemet që ballafaqojnë ata që punojnë në fushën e shkencës. Në rendin tonë të ditës nuk kemi pasur asnjë ligj mbi shkencën. Një dështim tjetër i madh është që nuk i kemi krijuar institucionet për tejkalimin e krizës dhe zbutjen e tensioneve në mes bashkësive etnike. E pranoj që as unë nuk kam pasur mjaft guxim. Më duket që këto çështje mbeten për tu trajtuar

pas zgjedhjeve.

ASI: Cila institucioneve iu referoheni?

Mendoj në institucionet në formë të organeve ose mekanizmeve që duhet të jenë më të afërt me problemet me qëllim të zgjidhjes së tyre. Duhet të ekzistojnë mekanizmat institucionalë brenda Parlamentit ose Qeverisë me qëllim të parandalimit ose të tejkalimit të përçarjeve brenda IPVQ-ve. Më duket që në këtë drejtim nuk ia dolëm që jostabiliteti do të rritet gjatë periudhës në vijim.

ASI: A do të jetë situata e paqëndrueshme për shkak të zgjedhjeve të ardhshme?

Kjo është arsyeja kryesore. Mund të ketë rritje të temperaturës për shkak të partive politike që do të luftojnë ashpër për të ardhur në pozitë dhe për t'i fituar zgjedhjet. Poashtu kanë shumë çështje për të kritikuar, siç janë situata në ekonomi, drejtësi dhe siguri. Të gjitha këto aspekte do ta vështirësojnë situatën. Shpresoj të kemi zgjedhje normale ndërkohë që ne do të përpiqemi në Parlament të bindim elektoratin për të dalur dhe votuar. Nëse votuesit e pakënaqur nuk dalin në votime, do të kemi probleme në të ardhmen. Është e mundur që më pak se 50 përqind të elektoratit të marrin pjesë në votimet e ardhshme.

ASI: E cekët që Kuvendi nuk ka pasur sukses në disa lëmi. A do të thotë kjo që do të pasojnë disa ndryshime në strukturën e brendshme të Kuvendit?

Shpresoj që Parlamenti i ardhshëm të ketë numër më të vogël të partive të përfaqësuara. Shpresoj që si rezultat i zgjedhjeve të ardhshme do të dal një opozitë në Parlament, jo një opozitë etnike por një opozitë e fuqishme e cila do të mbajë Qeverinë përgjegjëse aq sa duhet. Do të na nevojitet akoma ndihmë nga shtetet me traditë të gjatë të demokracisë dhe nga shtetet që kanë tejkuluar problemet etnike nga e kaluara. Nuk dua të jem i vetmuar, dhe nuk flas për veten time, Nexhat Dacin, por Kryeparlamentari duhet të mbështetet në një ekip të ekspertëve vendor dhe ndërkombëtar. Bashkësia ndërkombëtare duhet të ketë një rol këshillëdhënës për institucionet tona. Kjo do të ketë rezultate pozitive.

ASI: Diç më tepër në lidhje me strukturën organizative të Kuvendit. A parashihni ndryshime në marrëdhëniet në mes Kryesisë së Kuvendit dhe Kryeparlamentarit, Kryesisë dhe Kuvendit ose brenda

Sekretariatit të Kuvendit?

Mendoj që nuk duhet të kemi më Kryesi. Kjo është një traditë e vjetër nga Jugosllavia e Titos sepse brenda Kryesisë ekziston një tendencë e fuqishme për favorizimin e interesave të partive politike. Me gjasë në vend të saj do të duhej të kenim një Bord, me Kryetar dhe një numër të kufizuar nënkryetarësh. Nuk mund të ankojmë në Kryesinë aktuale dhe në të vërtetë duhet të jem falenderues sepse kemi bashkëpunuar ngushtë. Është interesante që kam pasur përkrahje të madhe nga anëtarët e Koalicionit Kthimi në Kryesi. Në përgjithësi puna në Kryesi ka qenë mjaft konstruktive. Do të dëshiroja që fryma e njejtë të mbretëronte edhe gjatë seancave. Komisionet poashtu kanë bashkëpunuar mirë. Seancat nganjëherë nuk kanë qenë të tilla, me gjasë për shkak të pranisë së mediave por jam i mendimit që shikuar në përgjithësi, anët pozitive dhe negative, ky Parlament ka qenë i suksesshëm. Dhe ia doli të mbajë Kosovën stabile. E dini që shumë shpesh kam marrë iniciativa që kanë tejkuluar funksionin tim si Kryetar i Kuvendit. Nuk e kam bërë këtë për ta luftuar UNMIK-un ose dikë tjetër por për ta mbajtur situatën nën kontroll. Nëse situata del jashtë kontrollit në Kosovë, do të mund të përhapej në tërë rajonin.

ASI: A mendoni që raporti me UNMIK-un ka gjasa të përmirësohet apo ndoshta edhe të keqësohet me ardhjen e PSSP të ri?

Mendoj që PSSP Holkeri u mundua mjaft. Ishte njeri i ndershëm. Në të kam parë një politikan mjaft serioz por UNMIK-u është i strukturuar në atë mënyrë që nuk mund të ketë sukses. Gjithmonë përpiqem të jem i ndershëm dhe i sinqertë. Nuk mendoj që situata do të përmirësohet. Kam pasur



Prof. Nexhat Daci, Kryetar i Kuvendit të Kosovës

shumë takime me Holkerin dhe jam përpjekur ti ndajë analizat e mia me te sepse mënyra ime analitike vie nga shkenca dhe shumë shpesh është e saktë. I pata sugjeruar që të mos shkoj plotësisht, nuk e dua këtë, por ti ndryshojë strukturat. Misionet e KB-ve kanë probleme kudo në botë. Do të ishte mirë të caktohet një afat kohor dhe të kryhet puna. Jam optimist rreth PSSP-së të ri. Do ti nevojitet kohë për tu familiarizuar me situatën. Poashtu edhe KB-ja është një strukturë shumë e ndërlikuar pasi që në përbërjen e saj ka shumë shtete, ku secili ka interesat e veta, dhe jo domosdoshmërisht të njëjta me ato të KB-ve. Është shumë vështirë të punohet në këto rrethana. Tri vitet e para ishin shumë të suksesshme në Kosovë me rezultate shumë të mira në rindërtim dhe në fusha tjera, por pastaj suksesit filloi ngadalë të bie. Shpresoj të vie dikush që do të ndryshojë gjendjen në të mirë Poashtu shpresoj në partneritet të vërtetë.

ASI: Çka në lidhje me standardet? A shpresoni në standarde?

Standardet janë në masë të madhe të pranuar në Kosovë. Nuk jam shumë optimist

që me mjetet që posedojmë mund të jemi shumë të suksesshëm. Parlamenti duhet ti plotësojë standardet që ndërliken me Parlamentin por do të jetë vështirë nëse serbët nuk marrin pjesë në procesin e standardeve dhe në jetën politike. Kam pasur një takim me disa udhëheqës të KP-së dhe kam vërejtur e që kjo mund të ndryshojë në të ardhmen. Kam qëllimin të vazhdoj bisedimet me ta dhe shpresoj të punojmë bashkarisht.

ASI: Çfarë hapa mund të ndërmerri për të i përmirësuar marrëdhëniet me pakicat?

Duhet të gjejmë mënyra. Kritikta ndaj serbëve nuk mund të jenë zgjidhje për Kosovën. Mospjesëmarrja nuk është zgjidhje për serbët. Kështu që duhet të gjejmë mënyra për ata të cilët janë të interesuar të jetojnë dhe të kenë prona në Kosovë. Duhet të respektohen të drejtat e tyre: të drejtat pronësore, të drejtat e njeriut, të drejtat e punësimit dhe ato afariste. Unë dhe shumica e popullsisë jemi të gatshëm për këtë. Shpresoj që Beogradi do ta kuptojë që serbët duhet të qëndrojnë këtu dhe të ndajnë të mirat dhe problemet e Kosovës.

Pengesat në rrugën drejt standardeve

Nga Prof. Dr. Hajredin Kuçi, Nënkyetar i PDK-së dhe Deputet në Kuvendin e Kosovës

Standardet për Kosovën të cilat u inicuan jo edhe aq larg nga ish PSSP, z. Mihajl Shtainer, janë bërë tema më e diskutuar në debatin tonë publik. Është me rëndësi të ceket që standardet janë të rëndësishë qenësore. Ato paraqesin kornizën e veprimeve të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, por edhe të gjithë qytetarëve të Kosovës, me qëllim të krijimit të një shoqërie me një rend të konsoliduar demokratik.

Standardet paraqesin një strategji të punës të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare në Kosovë që është ose duhet të jetë në pajtim me të kuptuarit dhe pikëpamjet e secilës qeveri demokratike në Kosovë tash dhe në të ardhmen, madje edhe pas definimit të statusit të Kosovës. Në të vërtetë, standardet janë në përputhje me përpjekjet e vazhdueshme për krijimin e institucioneve demokratike në Kosovë në pajtim me standardet ndërkombëtare, me qëllim të krijimit të kushteve të barabarta për të gjithë qytetarët e Kosovës pa marrë parasysh prejardhjen e tyre etnike, fetare, gjinore ose racore.

Ekzistojnë tre akterë kryesorë të përfshirë në përpjekjen e themelimit të një shoqërie të qëndrueshme demokratike: shqiptarët si shumicë, serbët si pakicë dhe bashkësia ndërkombëtare si një pjesëmarrës aktiv dhe si arbitër. Për t'i arritur caqet e standardeve në Kosovën e pas luftës, duhet t'i qartësujmë cilat janë pengesat në këtë rrugë. Pengesat fillojnë me qëllimin kryesor të tejkalmimit të përkufizimit të interesave kombëtare përmes parakushteve, të cilat me gjasë nuk janë plotësisht të arritura madje as në shtetet me sisteme më të konsoliduara demokratike.

Koncepti i "Standardeve para statusit" në mënyrë psikologjike përfshinë veprimet asimetrike të akterëve kryesorë, ngase objektivat politike ndryshojnë kur është fjala për shqyrtimin e statusit ligjor dhe politik të Kosovës. Derisa, nga në anë, shumica shqiptare dëshiron një shtet të pavarur dhe pakica serbe dëshiron kthimin e statusit të mëparshëm, bashkësia ndërkombëtare, nga ana tjetër, është e preokupuar me atë se si të bëhet vlerësimi dhe si të matet implementimi i standardeve. Në ndërkohë, çdonjëri është duke pasuar drejtimin e vet, ndërsa përmbushja e standardeve po kuptohet gjithnjë e më tepër si mjet për arritjen e objektivave vetanake politike.

Vlerësimi

Në të gjitha këto aktivitete, roli i bashkësië ndërkombëtare si arbitër është qenësore. Vlerësimi objektiv i përmbushjes së standardeve varet kryesisht nga PSSP. Nisuar nga fakti që shumë përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare qëndrojnë në Kosovë vetëm për një kohë të shkurtër, vetë vlerësimi është më tepër abstrakt se sa objektiv. Së këndejmi, sasia dhe cilësia si dhe plani kohor për implementimin e standardeve janë të një rëndësie të veçantë për Kosovën dhe qytetarët e saj, anipse këto çështje duken shumë abstrakte. Do të ishte e preferuar dhe shumë e dobishme të dihen faktorët dhe kriteret për vlerësim, që janë si parakushte për statusin përfundimtar e që për shumicën e kosovarëve është pavarësia. S'do mend se kjo do t'i motivonte, por njëherësh edhe do t'i obligonte më tepër institucionet si dhe qytetarët për implementimin e standardeve.



Prof. Hajredin Kuçi

Pakicat sipas standardeve

Shumica shqiptare mendon që pakica serbe është një faktor pengues dhe frenues, jo vetëm për procesin e implementimit të përsheptuar të standardeve, por edhe për procesin e bartjes së përgjegjësiave nga institucionet ndërkombëtare në ato vendore, me qëllim të ngadalësimit të procesit të pavarësimit të Kosovës.

Ndonëse krijimi i një mjedisi normal për pakicat besohet se është në duar të shumicës shqiptare, në të vërtetë pothuajse të gjitha mekanizmat e legjis-

lacionit, implementimit dhe ato gjyqësore janë në duart e bashkësisë ndërkombëtare, si përgjegjësi të rezervuara.

Njëkohësisht mund të themi se shumica asnjëherë nuk ka bërë dialog të mirëfillt dhe nuk ka bërë asnjëherë oferta të vërteta për pakicat, edhe pse ka tendencë dhe përpjekje për integrimin e pakicave në kuadër të institucioneve dhe jetës demokratike në Kosovë. Megjithatë, duhet vënë në dukje se edhe bashkësia ndërkombëtare është pjesërisht përgjegjëse. Ajo me kujdesin e tepruar ndaj pakicës serbe ka kontribuar në instrumentalizimin e tyre nga qarqet qeveritare dhe politike

në Beograd. Veç kësaj, pakica serbe akoma nuk ka hequr dorë nga synimi i saj për kthimin e Kosovës nën qeverisjen serbe. Kjo ka qenë e qartë në disa raste kur kanë shfaqur ide dhe plane antishqiptar, që në shumicën e rasteve janë të ngjashme me ato të regjimit shtypës të Millosheviqit. Pakica serbe akoma shihet në Serbi si lëvizje për riintegrimin e Kosovës në Serbi dhe jo si urë që mund të lidh këto dy shtete. Ndaj dhe nuk duhet të mbizotërojë bindja se e tërë puna rreth implementimit të standardeve është duke u

mentet e veta mbi mënyrën e interpretimit të implementimit të standardeve. Rivaliteti historik midis shqiptarëve dhe serbëve si dhe mungesa e vullnetit të bashkësisë ndërkombëtare për të qenë një arbitër me të vërtetë neutral përmes njohjes së të drejtave demokratike të shumicës së popullsisë së Kosovës, tregon qartë se sa e vështirë do të jetë përmbushja e shpejtë e standardeve.

Vështrimi krahasues

Standardet dhe përmbushja e

vjen, bashkësia ndërkombëtare nuk ka kontestuar të drejtën e Bosnë dhe Hercegovinës, Serbisë dhe Malit të Zi dhe IRJM-së që të jenë shtete të pavarura, edhe pse të drejtat e njeriut dhe krijimi i institucioneve të vërteta demokratike nuk është duke ecur me tempon e dëshiruar madje krahasuar edhe me Kosovën. Nuk dua të them që ne nuk duhet të jemi para tyre, por duhet të kemi mundësi të barabarta për përmbushjen e këtyre objektivave.

Nisur nga angazhimi i përgjith-

dardeve. Institucionet vendore dhe ndërkombëtare, por edhe qytetarët duhet të jenë më të kujdesshëm për të mos lejuar eskalimin e krizave, siç ndodhi në mars, qoftë për shkaqe politike, sociale apo ekonomike. Çdo krizë vështëron dhe pamundëson implementimin e standardeve. Sa herë që situata e përgjithshme është jostabile dhe kritike, edhe standardet janë në krizë.

Standardet përballë opinionit publik

Një element tjetër shumë i rëndësishëm është mënyra se si perceptohet formula dhe qasja "Standardet para statusit" nga opinionin publik. Duket se opinionin publik nuk ka bërë dallime se a janë këto vlera të njëmendëta apo thjeshtë propagandë. Deri më tash të gjitha insitucionet vendore dhe ndërkombëtare, individët dhe intelektualët kanë folur për standardet vetëm në mënyrë të përgjithshme. Standardet duhet të jenë "të prekshme" për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ndaj qytetarët e Kosovës duhet t'i shohin standardet si një rast për një jetë më të mirë dhe më të sigurtë, jetë ku respektohen identitetet personale dhe kombëtare. Të gjitha këto mund të arrihen vetëm përmes kontrollit të plotë të institucioneve mbi tërë territorin dhe mbi gjithë popullatën.



bërë për pakicat. Meqë pakicat bëjnë pjesë shumë pak ose fare në procesin e implementimit të standardeve, kjo de-motivon shumicën, ngase ata duhet ta bëjnë tërë punën rreth përmbushjes së standardeve, madje edhe pjesën e punës së atyre që nuk i përmbushin obligimet e tyre.

Jam i bindur që nëse formula "Standardet dhe statusi" para-prakisht do të përkufizohet në hollësi, në Kosovën e pasluftës ngjarjet do të zhvilloheshin ndryshe. Ndërsa tani standardet janë peng i konceptit "Standardet para statusit", ku secila palë është duke bërë përpjekje që t'i gjejë interesat e veta dhe po përpiqet t'i paraqes argu-

tyre nuk mund të kundrohen dhe konsiderohen ndarazi. Ekzistojnë disa dallime në përmbajtjen dhe formën e vendimmarrjes në mes të Kosovës dhe shteteve të tjera posaçërisht në sferën e sigurisë, shkalën e integritit multi-etnik, zhvillimin ekonomik, cilësinë e institucioneve publike, krimin e organizuar dhe problemet e privatizimit. Ndonëse ekzistojnë disa elemente të përbashkëta të standardeve me shtetet fqinje, të cilat në njërin ose mënyrën tjetër janë gjithashtu nën mbrojtjen ndërkombëtare. Megjithatë, ato janë shtete të pavarura, ndaj dhe bashkësia ndërkombëtare konsideron se vetëm në Kosovë nuk janë përmbushur standardet. Fjala

shme i bashkësisë ndërkombëtare dhe nga shumë fakte, kihet përshtypja se de facto standardet janë pretekst për shtyerjen e vendimit për statusin përfundimtar të Kosovës dhe se në të vërtetë nuk kanë për qëllim konsolidimin e rendit të njëmendët demokratik. Duket që ky qëndrim i bashkësisë ndërkombëtare buron nga paqartësia në kryeqytetet e Evropës Perëndimore mbi mënyrat e zgjidhjes së statusit politik të Kosovës.

Ndikimi i situatës së përgjithshme

Situata e përgjithshme në vend është një element i rëndësishëm në përmbushjen e stan-

Më shumë informata mbi Planin për Implementimin e Standardeve mund të gjenden në këto web-faqe:

Web-faqja e Kryeministrit:

http://www.pm-ksgov.net/focus_article.php?id_article=19

UNMIK:

<http://www.unmikonline.org/>

"Sa më shpejt të përmbushen standardet aq më mirë"

Intervistë me Ilir Dugollin, Këshilltar i Lartë Politik i Kryeministrit, mbi raportet me Kuvendin, Planin për Implementimin e Standardeve dhe punën e Zyrës së Kryeministrit.

Intervistë nga: Besnik Tahiri dhe Ulrich Steinle, OSBE

Asi: Z. Dugolli, a mund t'i përshkruani detyrat dhe përgjegjësitë tuaja kryesore brenda Zyres së Kryeministrit?

Pozita ime është e Këshilltarit të Lartë Politik të Kryeministrit, me fjalë tjera është pozita e këshilltarit kryesor politik. Si e tillë përgjegjësia ime kryesore është bashkërenditja e punës së të gjithë këshilltarëve politik dhe të emëruarve tjerë politikë të Kryeministrit dhe mbikëqyrja e punës së tyre. Në kuadër të portfolios sime është parashikuar përgjegjësia edhe ndaj Zyrës për çështje ligjore.

Asi: Ju jeni njëri nga anëtarët e "ekipit të ri" brenda ZKM-së. A mendoni që mund të ndikoni në politikat dhe cilat mendoni që janë shansat për këshilltarët e rinj politikë në institucionet e Kosovës?

S'do mend se ekipi i Kryeministrit është i ri. Unë jam 28 vjeçar ndërsa këshilltarët tjerë janë kryesisht në fillim të viteve të tridhjeta. Kam filluar të punoj për Kryeministrinë para një viti e gjysmë, në një moshë relativisht të re. Gjatë kësaj kohe, fillimisht si nëpunës civil, unë kam vërejtur se Kryeministri vërtetë ka besim të madh tek të rinjtë dhe se është i gatshëm që t'u ofroj shansa atyre që janë të gatshëm të angazhohen. Unë besoj se ka mundësi relativisht të mira për ata këshilltarë të rinj, të cilët janë të interesuar për të kontribuar në krijimin e institucioneve. Mjerisht, në përgjithësi, mund të thuhet



Ilir Dugolli, Këshilltar i lartë politik i Kryeministrit të Kosovës

se ekziston një ngurrim i të rinjve për t'u inkuadruar në punën e Qeverisë. Megjithatë, është krijuar një ekipi i ri i Kryeministrit, që në masë të madhe ka inkurajuar interesimin e të rinjve për tu përfshirë në institucionet tona.

Asi: Cilat kanë qenë sfidat kryesore tuaja dhe të Zyrës së Kryeministrit? Cilat janë të arritura kryesore dhe ku ka ende probleme të mëdha?

Është vështirë të numërohen të gjitha sfidat kështu që do ti përmendi vetëm ato më kryesoret. Mungon përvoja paraprake, kompetencat janë

shumë të kufizuara, ekziston një paqartësi e madhe ligjore dhe politike dhe një kufizim i madh i përgjegjësive të Kryeministrit, i cili në të vërtetë është më tepër një koordinator pa kompetenca të mirëfillta ekzekutive. Ndërkaq ndër rezultatet më të rëndësishme janë ruajtja e kohezionit të qeverisë shumëpartiake, krijimi i shërbimit apolitik civil, që vazhdimisht është duke u përmirësuar, paraqitja e më se 60 projektligjeve në Kuvend dhe qëndrimi shembullor gjatë sfidës më të madhe të pasluftës, ngjarjeve të marsit 2004.

Asi: Reagimet e Kryeministrit gjatë krizës së marsit u vlerësuan nga bashkësia ndërkombëtare si reagimi më përgjegjës politik. Çka bëri që përgjigja e tij të dallojë nga ajo e akterëve të tjerë politikë?

Me të vërtetë roli i Kryeministrit është lavdëruar haptazi si nga përfaqësuesit kryesorë të bashkësisë ndërkombëtare, ashtu edhe nga qytetarët kosovarë. Unë mendoj se janë disa karakteristika të tij personale, të cilët kanë ndikuar që ai të veprojë në atë mënyrë, ndër to janë, fjala vjen, guximi i tij, ndershmëria, qasja aktive dhe përvoja në një mjedis të dhunshëm nga koha kur ka qenë

Kryetar i Komunës së Mitrovicës. Përshtypja jonë është se përpjekjet e Kryeministrit për t'i përmirësuar raportet midis komunitetit shqiptar dhe serb dhe për t'i riparuar dëmet e marsit kanë hasur në përkrahje të madhe nga qytetarët e të gjitha etniteteve.

Asi: Me çfarë efikasiteti punon Qeveria së brendshmi, duke pasur parasysh problemin që duhet të qeverisni me një koalicion shumëpartiak dhe nganjëherë koordinim të dobët? A konsideroni se ka nevojë për përmirësime në këtë mes dhe nëse po, atëherë si?

Kujtoj që ka mjaft hapësirë për përmirësim sa i përket punës së Qeverisë. Ka pasur shumë lëshime nga aspekti strukturor dhe ligjor mbi të cilat është krijuar Qeveria. Kështu, nga njëra anë, nuk ka pasur mekanizma të duhur koordinues, ndërsa mjetet e monitorimit dhe intervenimit për Kryeministrin pothuajse nuk kanë ekzistuar fare. Për më tepër, nuk ka pasur as njësi të vërteta për hartimin e politikave. E gjithë kjo është vështirësuar edhe më tepër nga fakti që asnjë nga ministrat nuk është emëruar nga Kryeministri, kështu që i tërë ndikimi në monitorimin, implementimin e politikave ose intervenimin eventual është kufizuar në minimum.

Asi: Si është sipas mendimit tuaj bashkëpunimi me Kuvendin? A është marrë Kuvendi në mënyrë profesionale me ligjet e parashtruara nga ZKM-ja dhe çfarë janë kontaktet institucionale dhe personale me Kuvendin? A mendoni që ka hapësirë për përmirësime?

Padyshim që të gjitha institucionet janë në përmirësim e sipër. Kontaktet personale i vlerësoj si shembullore dhe funksionojnë mirë. S'do mend se është dashur kohë dhe përpjekje për krijimin e kana-



Kryeministri i Kosovës Bajram Rexhepi dhe këshillëtarët e tij

leve procedurale adekuate të komunikimit. Kuptohet, kanalet dhe procedurat e tilla duhet ende të përmirësohen.

Asi: Kuvendi nganjëherë akuzohet për mos përpunimin e shpejtë të ligjeve. A mendoni një gjë e tillë qëndron?

Siç thashë, ka hapësirë që të gjitha institucionet të avancojnë punën e tyre dhe t'i përbushin më mirë detyrat dhe obligimet e tyre. Kjo vlen edhe për Kuvendin, i cili në shumë raste ka lënë përshtypjen e një organi që nuk është duke punuar aq sa duhet.

Asi: Sa mbështeteni në Planin për Implementimin e Standardeve për Kosovën (KSIP) gjatë përcaktimit të prioritetëve në punën tuaj?

Që nga inicimi KSIP është bërë një prioritet absolut. Veprimet që kërkohen padyshim janë udhërrëfyes si për punën e Qeverisë në tërësi, ashtu edhe

për Zyrën e Kryeministrit.

Asi: A mendoni që veprimet e parapara në KSIP mund të përbushen realisht brenda afërsisht një viti, brenda afatit kohor të caktuar në Plan?

Realisht është e pamundur të përbushen brenda një viti e gjysmë gjithë ato që UNMIK-u, me tërë resurset njerëzore, finaciare dhe resurset tjera, nuk ka qenë në gjendje t'i përbushë. Megjithatë, unë mendoj se besoj se është jashtëzakonisht me rëndësi që të arrihet maksimumi i asaj që mund të realizohet. Sa më shpejt të përbushen standardet aq më mirë, jo vetëm për statusin por edhe për cilësinë e jetës së secilit qytetar dhe për demokracinë. Po ashtu, besoj se ajo që është më e rëndësishme është përkushtimi për përbushjen e standardeve e jo rezultati përfundimtar i tyre.

Hollësitë e kontaktit:
Ilir Dugolli,
Ndërtesa e Qeverisë, zyra
E-213, rr. Nëna Terezë.
Tel.: 038-211-202
Fax: 038-211-200
E-mail: ilir.dugolli@ks-
gov.net

Më tepër informata mbi
Planin e Implementimit
të Standardeve mund të
gjenden në faqet vijuese
të internetit:
Faqja e internetit e Krye-
ministrit:
http://www.pm-ks.gov.net/focus_article.php?id_article=19
UNMIK:
<http://www.unmikonline.org/>

"Të gjithë duhet ta bëjmë maksimumin dhe duhet t'i lënë anash skepticizmin dhe dallimet"

Intervistë me Xhavit Halitin, anëtar i Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, mbi Planin e Implementimit të Standardeve.

Intervistoi: Doina Ghimici dhe Mevlyde Salihu, OSBE

Asi: Z. Haliti, çka mund të bëj Kuvendi për përmbushjen e Planit të Implementimit të Standardeve?

Të gjitha institucionet e Kosovës dhe Kosova si tërësi, jo vetëm Kuvendi, duhet të ndiejnë për obligim përmbushjen e standardeve për Kosovën. Të gjitha shtetet e rajonit duhet t'i përmbushin standardet e njejta nëse dëshirojnë të anëtarësohen në Bashkimin Evropian, NATO ose Këshillin e Evropës, edhe nëse nuk i quajnë standarde si ne në Kosovë. Ne si Kuvend kemi marrë përsipër përgjegjësinë mbi pakon e ligjeve që ndërlihet me standardet. Ne jemi dega legjislative e qeverisjes në Kosovë dhe kjo pako do të ketë prioritet gjatë seancave parlamentare. Është çështje tjetër sa ligje i dorëzohen Kuvendit. S'ka pikë dyshimi se do të ishte e udhës që vetë parlamentarët të inicojnë ligjet në lidhje me implementimin e standardeve dhe mos të presin që Qeveria t'i sponsorojë ligjet për ne. Ne kemi zhvilluar një debat në Kuvend lidhur me standardet dhe veç kësaj unë jam takuar edhe me përfaqësues të UNMIK-ut, të cilët merren me implementimin e standardeve. Do t'u sugjeroja të gjitha palëve të përfshira, që ta mbajnë këtë proces në jetë, ngase ne nuk mund t'ia dalim mbanë vetë. Pa dzshim se ky është një proces shumë i rëndësishëm për Kosovën.

Asi: A mendoni që brenda një viti Kuvendi realisht mund t'i përmbushë aktivitetet e parapara në Planin e Implementimit të Standardeve?



Z. Xhavit Haliti, Anëtar i Kryesisë së Kuvendit

Besoj që afati i përcaktuar është keqkuptuar nga të gjithë ne. Bashkësia ndërkombëtare nuk pret nga ne dhe Kosova të përmbushë diçka që shteteve tjera i janë nevojitur dekada, të paktën ashtu e kam kuptuar unë. Bashkësia ndërkombëtare më tepër dëshiron të na ofrojë një udhërrëfyes për të ardhmen me qëllim të vlerësimit se deri ku kemi arritur në rrugën e gjatë të standardeve dhe nëse ekziston vullneti ynë dhe i institucioneve tona për përmbushjen e standardeve, që janë normale për shtetet demokratike. Ata po ashtu do të vlerësojnë nëse ka vonesa dhe nëse po a janë këtë vonesa

të justifikueshme. Besoj që nga ana jonë nuk ka hapësirë që të jemi skeptik ndaj qëllimeve të bashkësisë ndërkombëtare, por të gjithë duhet të punojmë me përpjekje maksimale duke lënë anash skepticizmin dhe dallimet.

Asi: A mendoni që bashkësia ndërkombëtare është duke ofruar ndihmë të mjaftueshme për Kuvendin në përmbushjen e standardeve? Si mund ta forcojë bashkësia ndërkombëtare këtë proces?

Unë kujtoj se ka mundësi t'i ndihmohet Kuvendit dhe Qeverisë në përmbushjen e standardeve. Së këndejmi, do të apeloja për

më tepër ekspertë të jashtëm që do të punonin me deputetët me qëllim që t'u mundësojnë atyre hartimin e ligjeve që do të kontribuojnë jo vetëm në implementimin e standardeve, por edhe në përmirësimin e kushteve të jetës së përditshme në Kosovë. Unë besoj se i tërë Kuvendi do të mirëpriste një nismë dhe angazhim të tillë. Mendoj që vitin e ardhshëm vetë Kuvendi duhet të ndajë një shumë nga buxheti i saj për këshilltarë, për ekspertë nga Kosova dhe nga jashtë, ashtu që Kuvendi të jetë më aktiv në iniciimin e ligjeve dhe në përpunimin më të shpejtë dhe më cilësor të ligjeve.

Një shoqëri funksionale varet nga kredibiliteti i sistemit të saj demokratik

Nga 1 korriku deri më 31 dhjetor 2004, Holanda do të kryesojë Bashkimin Evropian. Për këtë arsye buletini informativ i ASI-të ftoi Kryesuesin e Zyrës holandeze në Prishtinë, z. Bas-Baker, t'u drejtohet lexuesve tanë.

Nga Peter Bas-Baker, kryesues i Zyres Holandeze të Ndërlidhjes në Prishtinë dhe Përfaqësues i Kryesisë aktuale holandeze të BE-së.

Për një person nga jashtë, Bashkimi Evropian (BE) mund ti duket si një deve, paksa e çuditshme dhe e komplikuar, por relativisht e sigurtë dhe shpresdhënëse për ata të cilët varen nga ajo. Që nga viti 1958 janë bërë shumë përmirësime në mekanizmat vendimmarrës të BE-së. Në këtë proces Parlamenti Evropian (PE) me hapa të ngadaltë por të sigurtë është shndërruar në një institucion të pazëvendësueshëm të strukturave institucionale të BE-së.

Ndonëse, PE-ja ende nuk është e përfaqësuar në Kosovë, ai megjithatë ka ndikim në vendimmarrje rreth ndihmës së BE-së në Kosovë. Në BE, Parlamenti luan rol crucial në marrëdhëniet ndërmjet votuesve dhe shoqërisë civile dhe institucioneve të BE-së. Në këtë mënyrë, PE-ja gradualisht është shndërruar në faktor të rëndësishëm sa i takon procesit të vendimmarrjes në BE, kontrollit të Ekzekutivit të BE-së dhe të hartimit dhe miratimit të një numri të madh të legjislacionit evropian. Deri më tash mbi 50% të legjislacionit holandez është hartuar në Bruksel. Po kështu, vlen të vihet në dukje se PE-ja luan rol vendimtar, tok me institucionet e tjera të BE-së, në miratimin e buxhetit të BE-së. Njëherësh, ka bërë mjaft edhe në thellimin dhe avansimin e elementeve demokratike të BE-së, ndonëse jo edhe aq sa duhet. Institucionet më të rëndësishme administrative të BE-së, Komisioni dhe Këshilli i BE-së, ende funksionojnë pa kontrollin dhe bilancin e

zakonshëm të një procesi të rëndomtë demokratik. Sipas sondazhve, PE-ja është institucioni më i shquar i BE-së. Megjithatë, dalja relativisht e ulët në zgjedhjet e fundit të PE-së dëshmoi se BE-ja dhe PE-ja duhet të bëjnë ende për t'i ndërgjegjësuar dhe inspiruar qytetarët e BE-së.

PE-ja ka vështësi me deficitin demokratik, që shfaqet gjatë procesit të bartjes së kompetencave nga niveli shtetëror i kontrolluar në mënyrë demokratike në institucionet e pakompletuara në mënyrë demokratike të BE-së. Edhe nëse ndonjëherë PE-ja nuk është në gjendje të ketë qasje te qytetarët e BE-së, ai prapë-prapë ka ndikim të madh në jetën e tyre të përditshme.

Përafrimi i institucioneve të BE-së me qytetarët ka qenë gjithmonë objektivi kryesor i Kryesisë së rradhës së Irlandës. Kjo është e një rëndësie të veçantë, ngase në fund të fundit suksesi i BE-së varet nga qytetarët e saj dhe nga kredibiliteti i sistemit të saj demokratik.

Kosova ka institucione të reja ndaj, në krahasim me Evropën, i duhet ende punë për ta fituar legjitimitetin. Në fund suksesi i Kosovës si shoqëri funksionale varet nga kredibiliteti i sistemit të saj demokratik dhe nga përkrahja që do të fitojë nga votuesit, përfshirë këtu edhe minoritetet, të cilat janë pjesë përbërëse e shoqërisë kosovare.

Për të krijuar një sistem të besueshëm demokratik votuesit duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë rezultateve të Insitucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), si e kanë kryer mandatin e tyre Qeveria dhe ministrat, sa ia kanë dalur mbanë partitë në Kuvend që t'i mbrojnë interesat e votuesve dhe përgjegjësisë së Qeverisë dhe ministrave për kompetencat e transferuara tek ata. Deputetët kanë mandat nga votuesit për të monitoruar Qeverinë aktuale dhe atë të ardhshme në përmbushjen e implementimit të standardeve, të cilat synojnë avancimin e mirëqenies së çdo kosovari.

Deputetët kanë mundësi, fjala vjen, që të monitorojnë Qeverinë si kur është fjala për hartimin dhe implementimin e legjislacionit të ri themelor ekonomik, i cili duhet të jetë në përputhje me standardet, ashtu edhe për suksesin e tërheqjes së investimeve dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

Të gjitha shtetet anëtare të BE-së në një apo në një mënyrë tjetër kontribuojnë në mbështetjen e projekteve për Kuvendin e Kosovës, që kanë për qëllim hartimin e legjislacionit ekonomik. Të gjitha shtetet anëtare të BE-së ofrojnë ekspertë bilateral ligjor përmes trajnimeve dhe seminareve në shtetet e tyre ose diku tjetër në Evropë. Edhe OSBE-ja ka projekte të ngjashme dhe shpresoj se Këshilli i Evropës së shpejti do të ofrojë përvojën e saj në forcimin e efikasitetit të Kuvendit në



Z. Peter Bas Backer, Udhëheqësi i Zyrës Holandeze për Ndërlidhje në Prishtinë

kontrollimin e institucioneve të tjera në kuadër të IPVQ-ve.

Të gjitha këto forcojnë kapacitetet e Kuvendit për të vepruar si një kontrollues dhe balancues i njëmendët i pushtetit në mekanizmat qeverisës të Kosovës. Çështja është nëse kjo ndihmon në afrimin e Kuvendit të Kosovës ndaj votuesve të saj. Gjatë fazës përgatitore të zgjedhjeve, deputetët mund t'i vizitojnë komunat për t'ua shpjeguar punën e Kuvendit dhe për t'i inkurajuar për pjesëmarrje në zgjedhjet e 23 tetorit.

Zyra Holandeze e Ndërlidhjes në Prishtinë
Fehmi Agani nr. 17
Dragodan
Tel.: 038-22 46 65
Email: nl_kosovo@yahoo.com

Një strukturë e shëndoshë e komisionit, por me hapësirë për përmirësime

Nga Pet Kedëll, Menaxher i Programit të NDI-së për Përkrahje Legjislative

Instituti Demokratik Kombëtar (NDI), në bashkëpunim me Iniciativën për Përkrahjen e Kuvendit (ASI), ka ofruar trajnime si dhe këshilla teknike dhe procedurale për Kuvendin e Kosovës, që nga inaugurimi i tij në nëntor të vitit 2001. Së këndejmi, NDI-ja do të përqëndrohet kryesisht në aspektet procedurale të funksionimit të Kuvendit. Duke e përqëndruar ofrimin e ndihmës teknike kryesisht në procesin legjislativ, NDI-ja ka kryer trajnime dhe i ka ofruar këshilla deputetëve rreth aktiviteteve si mbajtja e takimeve të komisioneve dhe seancave publike, përgjigja ndaj kërkesave për ndihmë nga zgjedhësit, përfshirja në mbikëqyrjen ekzekutive dhe përmirësimi i transparencës dhe përgjegjësisë ndaj qytetarëve të Kosovës. Për të përcaktuar nevojat për të ardhmen, çdo nëntë deri dymbëdhjetë muaj, NDI-ja kryen një hulumtim mbi statusin e komisioneve. Në vijim janë dhënë rezultatet kryesore të hulumtimit të fundit të mbajtur në prill 2004.

Në përgjithësi, gjendja e komisioneve është përmirësuar gradualisht që nga hulumtimi i qershorit 2003. Fjala vjen, tanimë shumë komisione e kanë bërë praktikë, që të organizojnë seanca publike për secilën ligj. Kështu, të paktën dhjetë komisione kanë mbajtur së paku nga një seancë publike gjatë vitit të kaluar. Njëherësh, janë mbajtur seanca publike jo vetëm për çështje të veçanta legjislative, por edhe mbi çështje të caktuara aktuale. Një praktikë tjetër e mirë që është krijuar është se shumica e komisioneve tashmë pothuaj në mënyrë rutinore i ftojnë përfaqësuesit e ministrive përkatëse

për të marrë pjesë në takimet e komisioneve për të siguruar informata dhe për t'u përgjigjur në pyetjet rreth projektligjeve që shqyrtim. Veç kësaj, asnjë nga komisionet, që janë përfshirë në hulumtimet e NDI-së, nuk kanë pasur vështirësi në sigurimin e kuorumit dhe shumë prej tyre kanë bërë vizita pune jashtë Prishtinës.

Megjithatë, mbështetur në disa konkluzat e caktuara mund të thuhet se ekziston një nevojë e vazhdueshme për përmirësimin e punës. Në vijim po i japim disa sferat në të cilat duhet të bërë përmirësime akoma.

1. Denduria e takimeve të komisioneve dallon jo vetëm brenda komisioneve por madje edhe brenda një komisioni. Ndërsa, disa komisioneve u janë dhënë në shqyrtim një numër i madh i projektligjeve dhe ato takohen gati çdo javë, disa komisioneve të tjera u jipen në shqyrtim ligje mjaft rrallë dhe së këndejmi, takohen vetëm nëse projektligji u referohet tyre.

2. Disa anëtarë të komisioneve, madje edhe kryesues, nuk janë plotësisht të kënaqur me kapacitetet dhe mundësitë e tyre për t'i shqyrtuar projektligjet ose për të ofruar amandamente.

3. Duhet të shqyrtohet çështja e mungesës së bashkëpunimit ndërmjet ekzekutivit dhe të disa komisioneve.

4. Shumë prej ligjeve të cilat kalojnë dhe miratohen nuk vihen në jetë nga ekzekutivi. Kjo njëherësh konsiderohet edhe si dobësi e Kuvendit, i cili ende ka vështirësi për t'a ushtruar detyrën e mbikëqyrjes ekzekutive.

5. Problem akoma i madh mbetet mungesa e kuadrit ligjor të trajnuar mirë, gjë që e bën të



Konferencë shtypi mbi publikimin e Doracakut për dëgjime publike më 26 maj

pamundur sigurimin e këshillave dhe informatave nga personi kompetent për projektligje gjatë takimeve të komisioneve. Një problem i ndërlidhur me mungesën e kuadrit është edhe mungesa e zyreve për kryesuesit e komisioneve si dhe mungesa e zyreve për takime.

6. Nuk ekziston Rregullore e veçantë e Punës për punën e komisioneve. Shumica e kryesuesve të komisioneve i përmbahen rregullave të procedurave plenare gjatë punës në komisione. Kjo do të thotë se procedurat ndryshojnë nga njëri komision në tjetrin.

7. Përkthimi akoma mbetet një faktor i cili ngadalëson procesin legjislativ. Versioni "zyrtar" i cilitdo ligj gjithmonë konsiderohet versioni në gjuhën angleze, gjë që mund të shkaktojë konfuzion. Kështu, ndryshimet e vogla në mes të versionit "zyrtar" dhe atij në gjuhën shqipe apo serbe mund të shkaktojë madje edhe keqkuptime lidhur me rëndësinë dhe efektin e një projektligji.

8. Grupet parlamentare nuk janë gjithnjë të informuara si duhet

nga udhëheqësia e tyre mbi qëndrimin në përgjithësi të grupit mbi një ligj të caktuar. Ndaj ende kemi raste kur anëtarët e një grupi parlamentar e përkrahin një ligj në Komision, por gjatë seancës plenare, grupi si tërësi mund edhe t'a kundërshtojë atë.

Marrë në tërësi struktura e komisioneve është e shëndoshë. Komisionet, që nga hulumtimi i fundit kanë bërë një përparim sa i takon mbajtjes së dëgjimeve të rregullta publike, kërkesave të ministrive për informim si dhe kuromeve dhe vizitave në terren. Në fushat tjera, si atë aftësimit të kuadrit, nuk është përparuar aq shumë. Në këtë hulumtim janë identifikuar disa fusha të tjera ku ka nevojë për përmirësime. NDI-ja ka përgatitur disa rekomandime, që mund të ndihmojnë në tejkalimin e ca mangësive në strukturën e komisioneve. Në bashkëpunim me kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit e komisioneve, rezultatet e hulumtimit do të bëjnë të mundur që të bëhen ndryshime të njëmendëta dhe të qëndrueshme.

Më shumë transparencë dhe përgjegjësi përmes Qendrës së re Informative të Qeverisjes Parlamentare

Nga Rogjer F. Roy, Menaxher i projektit SPEAK

Një element i rëndësishëm i Projektit të Përkrahjes së Arkivave Elektronike Parlamentare në Kosovë (SPEAK) është krijimi i një qendre informative jashtë hapësirave të Kuvendit të Kosovës. Ky qëllim u arrit në prill të vitit 2004 kur SPEAK-u nënshkroi një Memorandum Mirëkuptimi në mes UNDP-Kosovë dhe Unionit Ndër-Parlamentar, Kuvendit të Kosovës dhe Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Kosovës. Përmes këtij partneriteti tripalësh, Qendra Informative e vendosur në Bibliotekën Kombëtare, ka për qëllim t'i ofrojë opinionit publik qasje përmes internetit në sistemin e arkivës dhe në faqen e internetit të Kuvendit të Kosovës. Njëherësh, shfrytëzuesit në këtë Qendër do të kenë qasje edhe në një bibliotekë librash dhe botimesh periodike mbi çështjet e qeverisjes.

Qëllimi kryesor i Qendrës Informative të Qeverisjes Parlamentare (PGIC) është që të përkujdeset që Kuvendi i Kosovës të jetë më përgjegjës dhe më transparent ndaj të gjitha segmenteve të shoqërisë kosovare. Dihet mirëfilli që shumë kosovarë kanë pak njohuri për Kuvendin e tyre dhe punën e

tij sa i përket seancave plenare, legjislacionit që miraton ose merr në shqyrtim, shkallës së pjesëmarrjes e kështu me rradhë. Veç kësaj, nuk ka as informata, në të cilat mund të ketë qasje të lehtë nga studentët dhe grupet me interes, siç është puna e komisioneve parlamentare dhe biografite të deputetëve. PGIC-ja do të përmirësojë aktivitetet



e përfshirjes së qytetarëve në procesin legjislativ përmes promovimit të detyrave legjislative, të përfaqësimit dhe mbikëqyrjes së Kuvendit të Kosovës.

Në këtë qendër shfrytëzuesit do të kenë qasje në faqen e internetit të Kuvendit të Kosovës, në dokumentet publike nga baza e tij e shënimeve si dhe në faqet tjera të internetit, që u kush-tohen çështjeve të qeverisjes parlamentare. Një faqe e tillë e internetit është faqja e Unionit Ndër-Parlamentar me seli në Gjenevë, e cila është organizatë

ndërkombëtare e parlamenteve të shteteve sovraane e themeluar më 1889 (www.ipu.org). Aktualisht në kuadër të IPU-ja, e cila shërben si qendër e dialogut parlamentar botëror, janë mbi 130 anëtarë- parlamente kombëtare. Vet Unioni punon dhe angazhohet për paqe dhe bashkëpunim midis njerëzve dhe për krijimin e demokracive të qëndrueshme.

Njëherazi, Qendra Informative e Qeverisjes Parlamentare ka për qëllim inkurajimin e debatit dhe ngritjen e çështjeve të veçanta, që janë me rëndësi për shoqërinë kosovare. Tashmë është organizuar një seri ligjëratash publike mbi çështjet me interes për opinionin e përgjithshëm.

Ligjëratat e parë në PGIC mbi "Gratë kosovare në politikë" është mbajtur më 17 qershor 2004. Z. Robert Pajper, përfaqësuesi i UNDP-së në Kosovë ishte moderatori i ligjëratës së parë. "Çështjet gjinore nuk mund të zgjidhen vetëm përmes normave dhe rregulloreve të Kuvendit të Kosovës," sqaroi z. Pajper. "Ato vetëm ndihmojnë për të ofruar një kornizë për dhënien e mundësive të barabarta për gratë. Ndryshimi i vërtetë



Roger F. Roy, Menaxher i projektit SPEAK

duhet të vie nga udhëheqësit, të cilët e mobilizojnë shoqërinë civile dhe përkrahin nevojat dhe aspiratat e veçanta për të gjitha gratë kosovare."

Kjo ngjarje bërë të mundur që të bashkohen tri anëtarë të shquara të Kuvendit të Kosovës, Sala Ahmetaj, Hatixhe Hoxha dhe Edita Tahiri, së bashku me pjesëmarrës nga e gjithë shoqëria kosovare, për t'i këmbyer njohuritë dhe përvojat e tyre. Me këtë rast, folësit i shpallorën përpara audiencës pikëpamjet e tyre personale mbi rolin e grave në politikën kosovare dhe kjo rezultoi në një diskutim të gjallë me pjesëmarrje të audiencës. Gjatë muajve të verës dhe vjeshtës 2004 janë paraparë edhe ligjëratat tjera.

Seminari i tretë ndërparlamentar kosovaro-holandez

Nga Rene Vasilos, PPPLP, email: ewppp@ewppp.org, web-site: <http://www.ewppp.org>

Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (PPPLP), në kuadër të programit Aspekte dhe teknika të demokracisë parlamentare: një program në përkrahje të Kuvendit të Kosovës, me 18 dhe 19 qershor 2004 në Prishtinë organizoi seminarin e tretë ndër-

parlamentar kosovaro-holandez. Në mesin e pjesëmarrësve ishin anëtarët dhe ish-anëtarët e Parlamentit të Holandës dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës. Seminari u përqëndrua në këto çështje: detyrat dhe përgjegjësitë ndaj elektoratit, statusi ligjor i deputetit, fushata e hartimit të politikave partiake, dis-

kutimi i kompromiseve para-fushatës dhe qëndrimet paszgjedhore të partive politike.

Seminari i katërt ndërparlamentar do të mbahet në dhjetor dhe do të përqëndrohet në proceset paszgjedhore. Krahas seminareve, PPPLP-ja ka punuar me komisi-

nin e posaçmërisht hetues të Parlamentit, i cili është duke bërë hulumtime lidhur me krizën e marsit 2004. Në Santport të Holandës, nga 16 deri me 18 prilli 2004, është mbajtur një takim i komisionit me pjesëmarrjen e të gjitha partive të Kuvendit të Kosovës.

"Duhet të dëshmojmë që administrata nuk anon politikisht"

Intervistë me z. Isuf Demaj, Sekretar i Kuvendit të Kosovës

Nga Edmond Efendija, NDI

ASI: Z. Demaj, a mund t'u shpjegoni lexuesve tanë cilat janë përgjegjësitë kryesore për ju si Sekretar i Kuvendit dhe për Sekretariatit si tërësi?

Isuf Demaj: Interesi im kryesor është menaxhimi sa më i mirë me kuadrin e Kuvendit. Brenda një kohe relativisht të shkurtër, administrata e Kuvendit është bërë efikase dhe moderne dhe përpiqet të ofrojë shërbimet më të mira për Kuvendin e Kosovës.

ASI: Cilat janë sfidat kryesore me të cilat është ballafaquar Sekretariati i Kuvendit dhe cilat janë të arriturat kryesore të Sekretariatit dhe Kuvendit?

Demaj: Administrata, i tërë personeli dhe unë si sekretar, duhet të dëshmojmë që administrata nuk anon politikisht dhe kjo është një sfidë e madhe. Po ashtu duhet të kemi një bashkëpunim të mirë me OSBE-në, UNMIK-un dhe Qeverinë me qëllim të arritjes së synimeve tona dhe miratimit me kohë të projektligjeve.

Sekretariati është themeluar vetëm pas zgjedhjeve të fundit kështu që administrata ka qenë e papërgatitur për detyrat e saj dhe disa punëtorë nuk i kanë plotësuar kërkesat profesionale. Mund të them se kemi arritur mjaft rezultate, por duhet të punojmë më tepër për t'i shërbyer sa më mirë Kuvendit.

ASI: Ekzistojnë probleme teknike të cilat në një mënyrë apo në tjetrën e pengojnë punën e Kuvendit?

dit, siç janë mungesa e zyreve, nganjëherë mungesa e punëtorëve si për shembull në Departamentin ligjor. Kur mendoni se mund të tejkalohen këto probleme?

Demaj: Në fillim ka qenë shumë vështirë për deputetët dhe gjithë personelin në përgjithësi. Deri më tash deputetët kanë kuptuar se administrata ekziston për t'u shërbyer deputetëve, ndaj duhet të ekzistojë bashkëpunimi. E gjithë kjo ka rezultuar në atë që mund të quhet situatë e kënaqshme.

Në fillim as anëtarët e Kryesisë së Kuvendit nuk kanë pasur zyre. Megjithatë, ia kemi dalur mbanë të sigurojmë zyre për ata dhe për komitetet drejtuese të grupeve parlamentare. Deri në fund të vitit, Qeveria do të kalojë në ndërtesën e re qeveritare, atëherë ne do të kemi në dispozicion më shumë hapësirë për zyre. Ne kemi filluar rinovimin e ndërtesës së Kuvendit, kështu që më pas do të jemi më mirë të pajisur për kryerjen e detyrave tona.

ASI: Kuvendi nganjëherë akuzohet për mosefikasitet në shqyrtimin e projektligjeve. Çfarë është mendimi juaj mbi këtë?

Demaj: Sinqerisht mendoj se nuk ka bazë për një ide të tillë, pasi që Qeveria është ajo e cila i sponsoron projektligjet. Për secilin projektligj që arrin në Kuvend ekziston një procedurë, të cilës duhet t'i përmbahemi dhe i jemi përmbajtur gjithmonë. Në ndoshta 95% të rasteve, Kuvendi ka



Z. Isuf Demaj, Sekretar i Kuvendit të Kosovës

përfunduar me kohë shqyrtimin e projektligjeve dhe është miratuar një numër i ligjeve të rëndësishme. Shumica e ligjeve pastaj janë nënshkruar nga ana e PSSP-së, kurse ligjet që nuk janë nënshkruar, jam i sigurt që ai ka zyrën ligjore dhe kompetencat në duar të tij.

ASI: Ju jeni lidhja kryesore në mes Kryetarit dhe Kryesisë së Kuvendit si mmashment politik në njërën anë dhe Sekretariatit të Kuvendit, si menaxhment admin-

istrativ në anën tjetër. Si funksionon ky bashkëpunim?

Demaj: Besoj se jemi përpjekur për bashkëpunim të mirë. Deri më tash nuk kam pasur probleme as me Kryetarin e as me anëtarët e Kryesisë. Sa herë që janë kërkuar shpjegime nga unë ose stafi im, ne kemi qenë në krye të detyrës. Ndonjëherë ka pasur vërejtje rreth procesverbalit, por ky problem është zvogëluar në minimum.

ASI: A mendoni se Kuvendi ia doli mbanë në përmbushjen e

rolin të tij të mbikëqyrjes ekzekutive të Qeverisë dhe në ç'masë Qeveria u ka dalë zot kërkesave të Kuvendit?

Demaj: Qeveria është qeveri e koalicionit dhe nuk ka pasur shumë fërkime në mes Kuvendit dhe Qeverisë. Komisionet kanë filluar mjaft herët t'i ftojnë ministrat në seancat e tyre, edhe pse konsideroj se ky bashkëpunim mund të avancohej më tepër.

ASI: Cilat janë fushat kryesore në të cilat partnerët e ASI-të në të ardhmen e afërt do të mund të përkrahin Kuvendin?

Demaj: Gjatë çdo takimi me partnerët e ASI-të e kam theksuar këtë çështje të bashkëpunimit, pasi Kuvendi në përgjithësi, dhe më këtë mendoj i gjithë stafi dhe deputetët, kanë nevojë për përkrahje. Mendoj që është arritur mjaft, por s'do mend se mund të arrihet më shumë.

Mendoj se mund të ofrohet më tepër ndihmë për një administratë profesionale, në mënyrë që të mos jem i detyruar patjetër të merrem me çdo çështje. Në këtë drejtim mund të bëhet më tepër për ne dhe mund të takohemi me ata që janë të interesuar të na ndihmojnë. Të tillët s'janë të pakët. Duhet të jemi më konkret sa i përket ndihmës rreth përgatitjeve tona për zgjedhjet e ardhshme dhe deputetët e ri.

ASI: Kuvendi së voni ka punësuar një Zyrtar të Protokollit. Cilat janë detyrat kryesore të këtij zyrtari kontributi i tij për Kuvendin?

Demaj: Kuvendi nuk ka pasur njësinë e protokollit, madje edhe gjatë sistemit të kaluar ka ekzistuar vetëm një njësi e protokollit për Kosovën. Protokoli

është në interes të Kuvendit pasi që në të kaluarën ka pasur vizita të ndryshme dhe do të na nevojiten trajnimet për njësinë tonë të protokollit.

ASI: Nganjëherë cilësia e dobët e përkthimeve të projektligjeve, ka ngadalësuar punën e Kuvendit dhe shumë amandamente janë më tepër të natyrës gjuhësore se sa politike. Çfarë është vlerësimi juaj i përkthimeve ligjore dhe çka mund të bëhet më tej?



Demaj: Secili ligj që dorëzohet nga ana e sponsorit, paraprakisht nga ata kërkohet të përkthehet, të korrigjohet dhe të sigurohet cilësia adekuate gjuhësore dhe vetëm atëherë t'i paraqitet Kuvendit. Personalisht e kam diskutuar këtë çështje me Sekretarin e Përhershëm të Qeverisë me qëllim të tejkalimit të këtij problemi përmes punësimit të kuadrit i cili do të merrej profesionalisht me përkthimet. Na janë premtuar përmirësime, por nevoja është akoma prezente. Kemi krijuar një njësi të veçantë e cila merret me krahasimin e

versioneve në shqip dhe serbisht të dokumenteve ligjore. Kemi shpallur konkurse për vendet përkatëse, por meqë që rrogat nuk janë tërheqëse nuk kemi një shërbim të përkthimit të cilësisë së mjaftueshme.

ASI: Dihet mirë që ekspertët kosovarë kanë një reputacion të mirë, por gjithashtu jemi të vetëdijshëm se në Kosovë çdo gjë është e lidhur me politikë. A është vështirë të mbetet neutral dhe i paanshëm në një mjedis të tejpolitizuar siç është Kuvendi i Kosovës?

të standardeve pa ashtu adreson çështjen e punësimit të bashkësive joshqiptare brenda IPVQ-ve. Si është gjendja e punësimit në Kuvend?

Demaj: Jemi duke u ballafaquar me shumë vështirësi sa i përket kuadrit, jo vetëm shqiptarë por edhe serbë. Mbi 10% të punëtorëve tanë janë të bashkësisë serbe ose turke. Nuk bëjmë dallime etnike, ndaj dëshirojmë të kemi përfaqësim të drejtë të të gjitha bashkësive në përfundim me

strukturën e popullësisë.

ASI: Zgjedhjet janë caktuar për datën 23 tetor dhe priten deputetë të rinj në Kuvend. A është Sekretariati i përgatitur për deputetët e rinj?

Demaj: Ne do të bëjmë çmos për deputetët e rinj, por ndoshta nuk do të kemi kohë të mjaftueshme. Me gjasë, do të ketë deputetë të rinj dhe të vjetër dhe nëse ne si administratë do të kemi fillim të mbarë, atëherë nuk do të duhej të kemi vështirësi.

Demaj: Mua më duket mjaft lehtë ta mbajë një qasje të tillë dhe gjithmonë kam qenë neutral. Kështu që e kam mjaft lehtë kur flas me anëtarët e stafit tim dhe u them se nuk është e ndaluar të jenë të kyçur në politikë, por në Kuvend nuk mund të kenë pozicione politike. Nuk dua që kuadri administrativ të jetë i përfshirë në politikë sepse kjo mund të rrezikon punën tonë të përditshme.

ASI: Edhe plani i implementimit

“Roli i parlamentit në shoqërinë demokratike: marrëdhëniet me shoqërinë civile”

Nga: Catherine Perron, hulumtuese e lartë në Qendrën për Studime të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Paris dhe Prof. Dr. Nicolas Maziau, Udhëheqës i ekipit, Konzorciumi i tri parlamenteve i AER-it (hyrja)

Në kuadër të qëllimit më të gjerë për plotësimin dhe shtimin e marrëdhënieve midis Kuvendit dhe shoqërisë civile, projekti i AER-it në Kuvendin e Kosovës organizoi “Forum in ndërkombëtar për rolin e parlamentit në shoqërinë demokratike”. Forumi u mbajt më 24 dhe 25 qershor me deputetët që vinin ga Franca (Z. Christian Ménaud dhe Z. Jérôme Lambert), Belgjika (Znj. Zoé Génot dhe Z. Walter Muls), Gjermania (Znj. Petra Blass) dhe Kuvendi i Kosovës, si dhe me përfaqësuesit e shoqërisë civile të Kosovës.

Forum, i koordinuar nga Ambasadori Georges-Marie Chenu, ishte një mundësi për t'i mbledhur deputetët e tri parlamenteve nga Unioni European dhe anëtarët e Kuvendit të Kosovës për të diskutuar për çështje të ndryshme me interes të përbashkët. “Të jeshë parlamentar” dhe “Të jeshë ligdhënës” ishin dy pjesët e Forumit për të cilat ishin organizuar të gjitha debatet. Temat si “qytetaria dhe përfaqësimi”, “përfaqësimi dhe sistemi zgjedhor”, “puna në parlament dhe marrëdhëniet me votuesit”, “roli i anëtarëve të parlamentit në procesin e legjislacionit”, por gjithashtu edhe “marrëdhëniet midis qeverisë dhe parlamentit në procesin legjislativ” dhe “pjesëmarrja e shoqërisë civile në procesin legjislativ” ishin tema konkrete për të cilat i shkëmbyen pikëpamjet e tyre anëtarët e Kuvendit dhe përfaqësuesit nga shoqëria civile. Përfaqësuesit e ndryshëm të shoqërisë civile, të kyçur në çështjet siç janë papunësia, femrat në Kosovë, personat me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrja e minoriteteve në jetën publike, kishin mundësinë për t'i theksuar këto probleme dhe t'ua

sqarojnë pritjet e tyre anëtarëve të Kuvendit të Kosovës.

Konferenca përfundoi me raportet përmblylëse të Z. Ylber Hysa, drejtor ekzekutiv i “Aksionit Kosovar për Iniciativa Qytetare” (KACI) dhe Znj. Catherine Perron, hulumtuese e lartë në Qendrën

qendror, që përfshin disa veçori që dallojnë prej njëra-tjetrës. Ekziston përgjegjësia për ta kontrolluar qeverinë dhe për të debatuar mbi ligjet, përdërisa në të njëjtën kohë ata janë edhe përfaqësues të qytetarëve. Poashtu ekzistojnë edhe funksionet e tjera, si

jtën kohë. Ata duhet t'i ndërprejnë shprehitë e mëparshme, të fituara gjatë komunizmit si edhe gjatë regjimit të Millosheviqit dhe ata duhet ta përgatisin terrenin për një Kosovë pluraliste dhe demokratike në të ardhmen.



Forum i AER i mbajtur më 24 qershor 2004

për Studime të Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Institut d'Etudes Politiques de Paris. Në vazhdim gjendet një version i shkurtuar i raportit të Znj. Perron.

Sipas traditës, parlamentarët janë në qendër të sistemit demokratik. Ata bashkëveprojnë ndërmjet tri poleve: qeverisë, partive politike dhe qytetarëve. Ata kanë një funk-

frymëzimi i jetës politike dhe integrimi i komunitetit politik. Sa i përket anëtarëve të Kuvendit të Kosovës, siç duket këtyre elementeve tradicionale u janë shtuar edhe disa funksione të tjera, që kanë të bëjnë me specifikat e situatës në Kosovë. Parlamentarët e legjislacionit të parë demokratik të Kuvendit të Kosovës përfaqësojnë një ndarje dhe një rilindje në të një-

Ata kanë një përgjegjësi shumë të madhe, shumë më të madhe se sa që e kanë parlamentarët në demokracitë e zhvilluara. Anëtarët e Kuvendit në Kosovë veprojnë si pionierë të demokracisë. Me fjalën “pionier” nënkuptoj aspekte të ndryshme: ata janë të parët që e ushtrojnë demokracinë në Kosovë. Ata punojnë në një institucion të cilit i mungon

rutina, në të cilin ata duhet t'i vendosin zakonet e reja dhe të zbulojnë tradita të reja. Mënyra se si sillen ata është me rëndësi, pasi që kjo do të lejë gjurmë. Mënyra e tyre e punës do të trashëgohet nga pasardhësit e tyre, të cilët do të vazhdojnë nga aty ku ka mbetur Kuvendi i mëparshëm. Megjithatë, ata gjithashtu janë njerëzit që rezikuan, që janë pajtuar ta fillojnë këtë aventurë ku sukcesi nuk është i garantuar.

Funksioni i përfaqësimit të qytetarëve është bazë e legjitimitetit. Si zyrtarë të zgjedhur anëtarët e Kuvendit janë interpretues të vullnetit të qytetarëve. Këta të fundit i kanë caktuar anëtarët e Kuvendit që të flasin në emër të tyre, por ata gjithashtu i kanë shprehur edhe dëshirat e tyre politike. Sidoqoftë, pozita e anëtarëve nuk është shumë e favorshme: ata duhet t'i japin përgjegjësi atyre që i kanë zgjedhur dhe në të njejtën kohë të luftojnë për bindjet e tyre. Ata veprojnë si përfaqësues të cilët e shprehin vullnetin e qytetarëve, gjë e cila nuk është gjithmonë e dukshme. Shumë nga anëtarët tanimë e kanë theksuar sa problematike është çështja e përfaqësimit të Kosovës, duke i patur parasysh komunitetet joshqiptare. Tjetër pikë për debat ka qenë edhe përfaqësimi i femrave. Megjithatë, përfaqësimi i komuniteteve joshqiptare dhe femrave më në fund është bërë një rezik më tepër simbolik se sa teknik. Kjo ka të bëjë me llojin e barazisë të cilin shoqëria kosovare e sheh si të rëndësishëm dhe çfarë është imazhi të cilin shoqëria dëshiron ta krijojë për vetë.

Të kthehemi për një çast te problemi më i përgjithshëm i përfaqësimit dhe marrëdhëniet ndërmjet zyrtarëve të zgjedhur dhe qytetarëve, madje edhe te përkufizimi se çka është qyte-

tari dhe roli i tij në procesin demokratik. Ekziston reziku, i cili nuk është i veçantë vetëm për Kosovën, që të kufizohet roli i qytetarëve në të drejtat e tyre themelore politike, pra në të drejtën e tyre të votës. Ndonjëherë elita politike tenton t'i lejojë qytetarët të marrin pjesë vetëm në zgjedhje. Kjo e tregon një vizion të kufizuar dhe formal të demokracisë, në të vërtetë një vizion tejet statik të saj.

Megjithatë, me qëllim që të kemi një qeverisje demokratike afatgjate, dhe një proces të suksesshëm të demokratizimit për Kosovën, është thelbësore të ketë një qasje më dinamike ndaj rolit të qytetarit në demokraci. Në këtë drejtim, zyrtarët e zgjedhur kanë një rol shumë të rëndësishëm. Prej tyre varet ta sigurojnë lidhjen me votuesit pas zgjedhjeve. Nëse vazhdimisht kërkohet nga zyrtarët e zgjedhur t'i zhvillojnë kontaktet me votuesit e tyre dhe me sektorin joqeveritar, e tërë kjo kërkon gjithashtu edhe pajisje (zyra, hapësira për pranimin e votuesve, ndihmësa të parlamentit etj...), që nuk janë vetëm përkrahje teknike por edhe mjete të domosdoshme për ushtrimin e pushtetit të një anëtari të Kuvendit.

Gjatë debateve, unë isha i befasuar të vëreja se lidhja midis deputetëve dhe partive të tyre politike nuk është përmendur aq shpesh. Sidoqoftë, si duket partitë politike kanë një rol qendror. Ato e mishërojnë pluralizmin e ideve. Ato i formulojnë propozimet për të ardhmen dhe për zhvillimin e shoqërisë. Ato i themelojnë listat zgjedhore dhe sigurojnë përkrahje logjistike për anëtarët e parlamentit.

Në këtë rast, Gjermania mund të merrret si shembull. Atje, roli i partive politike është çështje

kushtetuese. Unë do t'i referohem dy elementeve kryesore: (1) partitë e kanë për obligim të kontribuojnë në zhvillimin e opinionit të qytetarëve; (2) partitë e kanë për obligim të jenë në pajtueshmëri me rregullat e shtetit demokratik. Supozohet se partitë politike janë shumë më tepër se sa një makineri për marrje të pushtetit. Ato përfaqësojnë mjetet për demokratizim p.sh. duke u ndihmuar qytetarëve që ta zhvillojnë opinionin, duke e nxitur debatin politik dhe duke i informuar qytetarët për pasojat dhe ndikimin e ligjeve të miratuara. Këto janë mjete që u shërbejnë anëtarëve të parlamentit në kryerjen e detyrave të tyre duke u ndihmuar atyre t'i përgatisin strategjitë, të përfitojnë nga ekspertizat, të vendosin kontakte me shoqatat e ndryshme, organet profesionale, sindikatat, etj., duke u bërë kështu një vend për debate dhe ndeshje të mendimeve.

Duket e rëndësishme të rishqyrtohet aspekti i jashtëm i procesit të demokratizimit në Kosovë dhe ndikimet e tij në mandatin e përfaqësuesve të zgjedhur. Shumë anëtarë të Kuvendit insistuan në veçantinë e pozitës së tyre për shkak të detyrimeve të imponuara nga bashkësia ndërkombëtare. Ata e theksuan rëndësinë e kompetencave si një kusht për zbatimin e plotë të detyrave të tyre. Personalisht, unë sigurisht që i shoh disa sfida ndaj procesit të demokratizimit që ka të bëjë me statusin e pazgjedhur të Kosovës. Paqartësia e cila mbizotëron sa i përket statusit përfundimtar dhe ndjenja e varësisë së fortë nga zhvillimet politike në vendet fqinje, e dobësojnë procesin e demokratizimit. Bashkësia ndërkombëtare duhet të jetë e vetëdijshme për ndërlikueshmërinë e detyrës e cila i

është përcaktuar anëtarëve të Kuvendit dhe kushtet nën të cilat këta e ushtrojnë mandatin e tyre. Ç'është e vërteta, pa një shtet me kufinjë stabil dhe të garantuar, është e vështirë të ndërtohet demokracia dhe është e pamundur të vendoset sistemi efikas ekonomik. Pa ekzistimin e shoqërisë saktësisht të përkufizuar, e cila do të lejonte të identifikohet kush është qytetar e kush jo (ose së paku që i njeh si të tillë ose jo), është e vështirë për një zyrtar të zgjedhur të Kuvendit që plotësisht ta përmbushë rolin e tij të përfaqësimit politik. Është qenësore të dihet ku dhe në çka zbatohet sovraniteti me qëllim të përcaktimit të regjimit demokratik.

Në të njejtën kohë, tani më nuk është e mundur që arritja e pavarësisë të konsiderohet si disa dekada më parë. Sot, e drejta e popujve për vetvendosje ka të bëjë me respektimin e disa parimeve të caktuara, të dekretuara nga bashkësia ndërkombëtare përgjatë viteve, dhe në veçanti pas Luftës së Dytë Botërore. Disa prej tyre janë demokracia, respektimi i të drejtave të njeriut dhe të drejtave të komuniteteve që nuk e përbëjnë shumicën. Ato janë gjithashtu kushte që duhet të plotësohen me qëllim të hyrjes në Unionin Europian sipas kritereve që njihen me emrin Kriteret e Kopenhagës. Kështu që këto janë disa sfida me të cilat duhet të ballafaqohet Kuvendi i Kosovës.

Anëtarët e parlamentit kanë një rol të vështirë dhe interesant për t'i sintetizuar këto pritje ndonjëherë edhe kontradiktore, për të krijuar dhe gjallëruar demokracinë përkundër kufizimeve të sovranitetit i cili sipas meje nuk i nënvleftëson aktivitetet e tyre, por ndodh e kundërta!

Këshilltarët politik – lidhja në mes ministrive dhe Kuvendit

Nga Dr. Volf Preus, Këshilltar i FES-it në Zyrën e Kryeministrit

Me 3 qershor 2004 në organizim të përbashkët të OSBE-së, Institutit Kombëtar Demokratik (NDI) dhe Fondacionit Friedrich-Ebert-Shtiftung (FES), u mbajt seminari për këshilltarët politik të ministrave me temën "Bashkëveprimi në mes Qeverisë dhe Kuvendit". Ky seminar ishte pjesë e trajnimit më të gjerë, që u është ofruar këshilltarëve politik në maj/qershor 2004.

Fjalimi i Volf Preus, Këshilltar i FES-it në Zyrën e Kryeministrit, u përqëndrua në "Mbikëqyrjen ekzekutive dhe funksionin e kontrollit të Parlamentit". Mbikëqyrja, siç është përcaktuar me Rregulloren e përkohshme të Punës së Kuvendit, ngërthen në vetvete një mori instrumentesh (mjetesh) të veçanta të kontrollit parlamentar: pyetje që kërkojnë përgjigje me gojë, interpelime dhe pyetje që kërkojnë përgjigje me shkrim. Këto mundësi mund të përdoren në mënyrë shumë më aktive. Një përgjegjësi e veçantë është mbikëqyrja e implementimit të ligjeve nga ana e Kuvendit. Deri më tash, kjo detyrë e rëndësishme nuk është kryer si duhet, jo për vetëm shkak të mungesës së vullnetit, por edhe për shkaqe të tjera përfshirë këtu mungesën e resurseve, mungesën e kuadrit dhe mungesën e trajnimeve. Në këtë drejtim duket që ekziston një çekuilibër i kompetencave në mes Qeverisë dhe Parlamentit. Për ta tejkaluar këtë çekuilibër lipsen kuadro të mjaftueshme të kualifikuara, të cilët do ta përkrahin punën e Parlamentit.

Për të tejkaluar pjeërisht këtë situatë të pakënaqshme, Kuvendi pothuajse rregullisht ka përdorur instrumentin e seancave publike. Kështu, më



Këshilltarët politikë në seminarin e mbajtur më 3 qershor

se njëzet seanca e mbajtura për gati një të tretën e projektligjeve, kanë shërbyer si mjete të dobishme për përfshirjen e zërave të rëndësishëm të shoqërisë civile në diskutimet e Kuvendit. Në maj të vitit 2004, OSBE-ja dhe NDI-ja kanë botuar një "Doracak mbi seancat publike". Ky është një udhëzues mjaft praktik dhe i dobishëm për përgatitjen dhe udhëheqjen e seancave parlamentare.

Sa i takon raporteve të përgjithshme në mes Parlamentit dhe degës ekzekutive, "përshkrimi i detyrave" përkëshilltarët politik, që u hartua kohë më parë, i jep atyre një përgjegjësi të veçantë karshi Kuvendit. Kështu, në këtë përshkrim të punës është parashikuar që në raport me Kuvendin këshilltarët politik "ta kanë rolin e personit kontaktues për Ministrinë". Ministri duhet të vendos se cili nga këshilltarët e tij politik duhet të marrë përsipër këtë rol të rëndësishëm. Roli i saj/tij do të jetë bashkërenditja e kontributeve të Ministrisë për Kuvendin dhe komisionin/et përkatëse. Ajo/ai duhet të sigurojë që deklaratat vis-a-vis një komisioni të jenë të

bashkërenditura mirë në mes të njëjësive punuese të një ministrie. Një punë tjetër e rëndësishme për këshilltarët politik do të jetë bashkërenditja dhe përgatitja e versionit përfundimtar itëpërgjigjeve dhe interpelimeve nga Kuvendi. Gjatë hartimit të ligjit nga një ministri, përgjegjësia e saj/tij do të jetë krijimi jozyrtar i kontakteve të hershme me Zyren Ligjore të PSSP-së me qëllim të përshpejtitimit të procesit legjislativ përmes shmangies së befasive të pakëndshme në fazat e mëvonshme. Si pikë kontakti i/e Kuvendit, ai/ajo do të jetë përgjegjës edhe për sigurimin dhe ruajtjen adekuate të "përgjegjësive ekzekutive" ndaj Kuvendit dhe komisionit/eve të përfshira. Kjo është një detyrë "mbikëqyrëse", e cila është e një rëndësie të veçantë për këshilltarët.

Roli i këshilltarëve politik në raport me Kuvendin është adresuar publikisht nga Daut Beqiri, Drejtor i Departamentit Ligjor të Kuvendit, dhe nga Pae Kedëll, Koordinator për Çështje Legjislative i NDI-së. Daut Beqiri vuri në dukje se në shumicën e rasteve këshilltarët politik në

të vërtetë nuk njihen nga ana e Kuvendit. Ata në të vërtetë konsiderohen si të rëndësishëm, por si "hije e zezë" pas Ministrit, meqë deri më tani roli i tyre në raport me Kuvendin dhe stafin e tij nuk ka qenë i qartë. Mirëpo, kjo mund të ndryshojë pas pranimit zyrtar të "përshkrimit të ri të punës" për këshilltarët. Z. Beqiri nënvizoi që Kuvendi në të ardhmen duhet të jetë më mirë i informuar rreth implikimeve financiare të ligjeve që paraqiten nga Qeveria. Formulimi i zakonshëm "pa implikime buxhetore" shumë shpesh është treguar i gabuar. Kjo detyrë mund të jetë një përgjegjësi e veçantë e personave kontaktues.

Pet Kedëll i inkurajoi këshilltarët politik që të veprojnë si pika të ardhshme fokale për të bërë të mundur përcjelljen sistematike të çdo projektligji përgjatë tërë procesit në Parlament, duke filluar që nga shqyrtimi i parë. S'ka pikë dyshimi se kjo ka rëndësi të veçantë sidomos atëherë kur komisionet funksionale kanë nevojë për bashkëpunim të vazhdueshëm me Qeverinë dhe në rastet kur janë duke u shqyrtuar amandamentet e projektligjeve.

Ky debat mjaft energjik ngriti në mes të çështjeve të tjera edhe çështjen pse një "përshkrim i këtillë i punës" për këshilltarët politik dhe seria e këtyre seminareve trajnuese ndodhën kaq vonë, pak kohë para zgjedhjeve të ardhshme të përgjithshme. Mirëpo, edhe përkundër vonesës, është më rëndësi që megjithatë të qartësohet ky rol, në mënyrë që të paktën të shmanget një vakum i këtillë në punën e këshilltarëve të rinj politik pas zgjedhjeve.

Konferenca mbi zhvillimin ekonomik ve në dukje perspektivën evropiane

Nga z. Klaus Bynger, ish Sekretar Shteti në Ministrinë e Ekonomisë, Gjermani

Konferenca "Zhvillimi ekonomik i Kosovës – idetë, konceptet dhe pengesat" e mbajtur më 8 qershor pikë së pari pati për qëllim forcimin e dialogut ndërmjet Qeverisë, Kuvendit, UNMIK-ut, komunitetit të biznesit dhe shoqërisë civile. Kjo konferencë u organizua nga Fondacioni Fridrih Nauman (FNSt) në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Kosovë dhe ASI-në. Në konferencë, në mes tjerash, morrën pjesë edhe Ministri i Financave dhe Ekonomisë, z. Ali Sadriu, Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, z. Ali Jakupi, përfaqësues të Odës Ekonomike të Kosovës, të Shtyllës së IV-të, USAID-i, RIINVEST-i si dhe përfaqësues të institucioneve të ndryshme ekonomike. Prezantimi i Kryesuesit të Komisionit për Financa dhe Ekonomi, z. Sllobodan Bjelliq, iu dorëzua përfaqësuesit të FNSt-së para fillimit të konferencës, ndaj dhe iu shpërndarë pjesëmarrësve të tjerë në seminar.

Pas fjalimit hyrës nga z. Rainer Villert, Koordinator i FNSt-së për Evropën Juglindore, u zhvillua një shkëmbim shumë i gjallë dhe kontradiktor i mendimeve. Pjesëmarrësit ranë dakord se situata makroekonomike në Kosovë është në nivel të kënaqshëm. Kështu, për buxheti u tha se është i qëndrueshëm, duke marrë parasysh se buxheti i vitit 2003 ishte 43 milionë € më i madh krahasuar me atë të vitit paraprak. Shkalla e ulët e inflacionit prej rreth 1% nuk e rrezikon zhvillimin ekonomik, derisa deficit i tregtisë së jashtme u vlerësua si problem serioz. Eksporti mbulon vetëm 4% të importit dhe dallimi i mbetur duhet të financohet nga transferi i kapitalit nga jashtë përmes organizatave ndërkombëtare dhe nga diaspora, gjë që e bënë Kosovën shumë të paqëndrueshme dhe të varur nga këto mjete të jashtme financiare.



Konferenca mbi zhvillimin ekonomik e mbajtur 8 qershor

Së këndejmi, shqetësim i veçantë u shpreh rreth gjendjes së vështirë ekonomike në Kosovë, duke i shtyrë disa të mendojnë se zhvillimi ekonomik ishte shumë i ngadalshëm dhe se mund të ketë rënie ekonomike. Papunësia vazhdon të rritet. Rritja e numrit të të rinjëve të papunë (mbi 50%) ishte identifikuar si shqetësim serioz për institucionet. Njëherit, janë identifikuar edhe probleme lidhur me përshtatjen strukturore janë paraqitur posaçërisht në sektorin e minierave, prodhimin e energjisë elektrike dhe në bujqësi. Z. Sllobodan Bjelliq u përqëndrua kryesisht në rëndësinë e ndërtimit të një rrjeti elektrik dhe në rritjen e investimeve në sektorin e arsimit. Njëherazi, u theksua se mungesa e shënimeve statistikore përbën një problem serioz për përgatitjen e analizave të plota dhe të sakta ekonomike.

Po ashtu u vu në dukje se një faktor tjetër, që ndikon në pengimin e zhvillimit ekonomik

janë fondet e pamjaftueshme për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Pos kësaj, u theksua edhe nevoja për përmirësimin e infrastrukturës së përgjithshme dhe për reduktimin e sektorit shtetëror. Në këtë kontekst u bënë disa ankesa jo vetëm rreth procesit të pezulluar të privatizimit, por edhe rreth mungesës së kuadrit të kualifikuar dhe korrupsionit të përhapur në masë të madhe.

Pjesëmarrësit në konferencë shprehën paknaqësinë e tyre rreth mungesë së kompetencave të Qeverisë së Kosovës. Ndërsa, USAID-i shtroi pyetjen nëse Qeveria e Kosovës është duke i përdorur kompetencat që tanimë i kanë marrë.

Ekzistojnë shumë ide për zhvillim dhe ecjen përpara në Kosovë, por këto ide duhet të koordinohen dhe bashkërenditen më mirë. UNMIK-u, Qeveria dhe Kuvendi duhet të zhvillojnë një koncept

të përgjithshëm për zhvillimin ekonomik në Kosovë dhe në këtë proces duhet të përfshihen përfaqësuesit e sektorit privat. Me këtë rast, perspektiva evropiane mund të shërbejë si një orientim, kuptohet duke u mbështetur në mësimet e nxjerrura nga shtetet e reja anëtare të BE-së. Rruga e ndjekur nga shtetet e reja anëtare të BE-së paraqet një program të suksesshëm të zhvillimit hap pas hapi të strukturës së ekonomisë së tregut.

Njëherësh, duke e marrë parasysh gjendjen e vështirë ekonomike u diskutua edhe rreziku i rritjes së tensioneve të brendshme. Kështu, për të krijuar parakushtet për uljen e tensioneve në Kosovë lipset një perspektivë pozitive dhe mbase një përqëndrimin më i theksuar drejt integritimeve evropiane, derisa Evropa është duke e shtuar gjithnjë e më tepër angazhimin e saj në Kosovë.

Serbët e Kosovës në mes Beogradit dhe Prishtinës

Nga Senad Saboviq, OSCE

Gjysma e parë e vitit 2004 ka sjellur ndryshime të mëdha politike në komunitetin serb të Kosovës. Përfaqësuesit e tyre, Koalicioni Kthimi (Koalicija Povratak, KP), gjatë pjesës më të madhe të këtij viti nuk kanë marrë pjesë në punën e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ). Kështu, bojkotimi filloi së pari për shkak të muraleve në korridorin e rinovuar të Kuvendit të Kosovës, por më vonë vazhdoi si përgjigje ndaj dhunës e cila së voni goditi Kosovën, në përgjithësi dhe komunitetin serb, në veçanti. Me këtë rast vlen të theksohet se dhuna e marsit lëkundur në masë të madhe besimin e bashkësisë serbe tek IPVQ-të dhe përfaqësuesit e tyre. Për më tepër, ndërrimi i Qeverisë në Beograd, në dhjetor të vitit 2003, shkaktoi disa ndryshime në ekuilibrin politik të serbëve në Kosovë.

KK-ja ka disa mangësi. Përkrahja e bashkësisë së tyre për pjesëmarrjen politike, ndonëse ka qenë e vazhdueshme, asnjëherë nuk ka qenë aq e madhe, posaçërisht në fillimit të vitit 2003 kur Dragiša Krstović erdhi në krye të KP-së. Kjo shënoi "kthesë të madhe" dhe rezultoi në përfshirjen më aktive politike të KP-së. Kjo politikë pro-aktive bëri të mundur ndryshime të konsiderueshme, posaçërisht në procesin legjislativ, duke siguruar në këtë mënyrë mosshkeljen e të drejtave dhe interesave të bashkësisë serbe të Kosovës në kornizën ligjore të Kosovës. Ndonëse kjo përfshirje provoi se përfaqësuesit e serbëve të Kosovës

ka rëndësi të veçantë, KP-ja megjithatë vazhdoi të shfaqë pakënaqësinë për shkak se qëndrimet e tyre nuk merreshin seriozisht nga zyrtarët shqiptarë të Kosovës të IPVQ-ve. Në të vërtetë, zyrtarët shqiptarë kanë bërë vazhdimisht thirrje për zgjerim të kompetencave të IPVQ-ve. Mirëpo, mocionet e tilla gati gjithmonë kanë hasur në rezistencë të KP-së, e cila i ka parë ato si mjete për të trasuar rrugën drejt pavarësisë.

Pakënaqësia e përfaqësuesve serbë të Kosovës të IPVQ-ve arriti kulminacionin në shkurt të vitit 2004, në kohën kur duhej të inaugurohej korridori i rinovuar i Kuvendit. Në hyrje të korridorit të rindërtuar dominonin murale me momente dhe motive nga historia shqiptare. Nuk kishte asgjë që simbolizonte dhe pasqyrore historinë ose traditën e serbëve ose të tjerëve në Kosovë. Për këtë arsye KP-ja vendosi që t'i bojkotojë seancat e Kuvendit, por vazhdoi punën në nën-organet e ndryshme të Kuvendit, përfshirë komisionet dhe grupet punuese. Dhuna e marsit shpërtheu pikërisht gjatë kësaj periudhe të tensionuar politike dhe së këndejmi, KP-ja filloi bojkotimin e plotë të të gjitha institucioneve. Bashkëveprimi i brishtë në mes serbëve të Kosovës dhe IPVQ-ve u dogj dhe u shkatërrua së bashku me shtëpitë e ndezura dhe të rrënuara gjatë dhunës. Përveç kësaj, shumë serbë të Kosovës konsideronin se dhuna vetëm sa e konfirmuar dhe forcuar besimin e tyre se pjesëmarrja në institucionet e Kosovës



Anëtarët e Kuvendit nga Koalicioni "Kthimi" në një seancë plenare në shtator 2003

nuk ka dhënë rezultate, ngase nuk ndikoi në parandalimin ose në evitimin e tragjedisë. Kriza e marsit forcoi bindjen e kahmotshme se pjesëmarrja politike në IPVQ duhej të shërbente për përfitime konkrete për bashkësinë e tyre ose për "legalizimin" e strukturave ekzistuese, nga të cilat mendohet se përfitojnë vetëm shqiptarët e Kosovës.

Besimi i komunitetit serbë të Kosovës është lëkundur në masë të madhe, sikundër edhe besimi se KK-ja mund të ndikojë dukshëm në punën e IPVQ-ve. Nga një anë, bojkotimi i IPVQ-ve ia pamundëson KK-së që përmes këtyre mekanizmave ta rikthejë një pjesë të besimit të bashkësisë së tyre, ndërsa nga ana tjetër, mungon ideja e qartë se çka do të ndryshonte nëse ata do të ktheheshin, për shkak të qasjes jokonstruktive, që ka treguar një pjesë e zyrtarëve të shqiptarëve të Kosovës.

Ndryshimet politike në Beograd kanë pasur ndikim dhe pasoja edhe në skenën politike të serbëve të Kosovës. Kështu, Qeveria aktuale e koalicionit në Serbi (e përbërë nga DSS, SPO-NS, G17 Plus, përkrahur nga SPS në Kuvend), përkrahë subjektet politike në Kosovë që janë jashtë KK-së. Në të vërtetë, lidhjet politike në mes Qeverisë serbe dhe serbëve të Kosovës tash kanalizohen përmes 'Këshillit Kombëtar Serb' (KKS), ngase DSS, i udhëhequr nga Kryeministri Vojislav Koshtunica, ka po ashtu rol udhëheqës në KKS, posaçërisht në degën veriore të Kosovës. KKS-ja shpesh ka një qëndrim jokooperativ, duke insistuar që akoma shumë larg përmeshja e kushteve për pjesëmarrjen e serbëve të Kosovës në IPVQ. Lidhjet politike në mes Qeverisë së Serbisë dhe KKS-së nuk do të thotë që kjo e para do të pranojë qasjen dhe qëndrimet e së dytës. Kjo më tepër ka të bëjë me konsoli-

dimin e kontrollit politik mbi serbët e Kosovës me qëllim të veprimit të përbashkët në Kosovë dhe rreth çështjes së Kosovës.

Veç kësaj, ka pasur ndryshime të kuadrit dhe strukturës së "Qendrës Koordinuese për Kosovë dhe Metohi" (QKKM). Meqë QKKM-ja është organ qeveritar, këto ndryshime kanë për qëllim përfshirjen e personave të afërt me koalicionin aktual në strukturat e QBK-së në Kosovë.

Është e mundur që gjatë muajve të ardhshëm si rezultat i zgjedhjes së Boris Tadiqit (DS) për Kryetar të Serbisë, të ketë edhe ndryshime të tjera. Tash është e mundur që DS të zëvendësojë SPS si përkrahje ndaj qeverisë aktuale minoritare ose madje edhe t'i bashkangjitet, duke pasur parasysh që DS ka pasur përkrahje të konsiderueshme gjatë zgjedhjeve presidenciale. Për ndryshe edhe nëse DS nuk i drejtohet Qeverisë, mund të parashikohet që partia të këshillohet para marrjes së vendimeve të rëndësishme.

Implikimet e zgjedhjeve presidenciale serbe për Kosovën mund të jenë dominimi i ripërtirë i anëtarëve të KK-së, pasi që KK-ja në përgjithësi është e lidhur ngushtë me bllokun politik rreth partisë DS. Për më tepër, tanimë mund të thuhet se Beogradi do të ketë ndikim përcaktues lidhur me atë se a do të marrin pjesë serbët e Kosovës në zgjedhjet e tetorit të Kuvendit apo jo. Nisuar nga situata e tanishme, nëse një vendim i tillë do të merret me pjesëmarrjen e DS-së.

Pjesëmarrja më aktive e komuniteteve të tjera në implementimin e standardeve

Doina Ghimici, OSBE

Më 8 qershor 2004 u mbajt një diskutim mjaft interesant dhe dobi të ndërsjellë mbi Planin e Implementimit të Standardeve për Kosovën (PISK) në mes z. Krein Ros, Koordinator i UNMIK-ut për Standarde dhe anëtarëve të grupit parlamentar të Komuniteteve tjera (KT).

Z. Ros shfrytëzoi rastin për t'i njohur anëtarët e Kuvendit të Kosovës mbi procesin e standardeve i cili tash është duke hyrë në fazën e tij vendimtare, i cili synon transformimin e objektivave në realitet. Meqë PISK-u saktëson se kush çka duhet të bëjë dhe brenda cilit afat kohor, atëherë duhet të krijohet një mekanizëm për vlerësimin periodik të përbashkës, monitorimit dhe përparimit të standardeve dhe njëherësh për të treguar mangësitë që paraqiten gjatë këtij procesi. Për këtë arsye, është marrë vendimi për riaktivizimin e grupeve punuese, që e kanë hartuar PISK-un.

Me këtë rast, zyrtarët e UNMIK-ut i inkurajuan fuqimisht deputetët e KT-së që t'i bashkëngjiten këtyre grupeve punuese dhe të kontribuojnë me përvojën dhe njohuritë e tyre për bashkësitë të cilat i përfaqësojnë në monitorimin dhe në përqendrimin e procesit të implementimit të standardeve. Pjesëmarrja e tyre aktive në këtë proces, sipas tij, është mënyra e vetme për të siguruar harmonizimin e asaj që është shkruar në letër dhe asaj që ndodh në realitet. Z. Ros u pajtua me vlerësi-



min e deputetëve të KT-së se ka pasur shumë përkrahje deklarative për standardet, por shumë pak prej tyre janë vënë në jetë. Megjithatë, ai pranoi që kanë kaluar vetëm dy muaj nga miratimi i Planit.

Njëherësh, deputetët e KT-së zunë në gojë shumë raste kur realiteti ishte në shpërputhje me standardet dhe se nuk janë ndërmarrur kurrfarë masa për tejkalimin e situatave të këtylla. Për më tepër, përshtypja e tyre ishte që askush nuk e ka të qartë prej nga të fillohet me zbatimin e standardeve. Së këndejmi, është duke u përgatitur një propozim konkret për fillimin e vlerësimit të gjendjes aktuale në fusha të ndryshme, në mënyrë që të kuptohet prej nga të fillohet me procesin e implementimit të standardeve.

Përfaqësuesit e KT-së shprehën pakënaqësinë e tyre rreth kujdesit të pamjaftueshëm nga ana e bashkësisë ndërkombëtare për minoritetet joserbe

dhe deklaruan që mbështetja më e madhe vije nga OSBE-ja. Ata kërkojnë përfshirjen e tyre në aktivitetet e bashkësisë ndërkombëtare, ndaj kërkuan që zyrtarët e lartë ndërkombëtarë, të cilët e vizitojnë Kosovën, përveç takimeve me përfaqësuesit e shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës, t'i vizitojnë edhe bashkësitë e minoriteteve joserbe.

Përfaqësuesit e këtij grupi parlamentar janë të bindur që nëse bashkësia ndërkombëtare u kushton më tepër vëmendje, atëherë do të shtoheshin edhe gjasat e tyre për të siguruar përkrahje më të madhe nga Qeveria. Çështjet kryesore që janë shqetësuese për KT-në janë politikat mbi gjuhën, barazia në punësim dhe arsim (ose madje edhe diskriminimi pozitiv në rastin e minoritetit romë) dhe qasja e drejtë në media. Njëherazi, ata ishin të mendimit, që duhet të parashihen mekanizma zbatuese dhe ndëshkuese për të siguruar implementimin e standardeve.

Përgatitja e zgjedhjeve parlamentare ecën sipas parashikimeve

Nga Hugh Fulton, OSBE

Për dallim nga tri palë zgjedhjet e kaluara, që u organizuan dhe mbikëqyrën nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, në zgjedhjet e vitit 2004 për Kuvendin e Kosovës ka ndryshime qenësore në menaxhimin e tyre. Kështu, më 23 tetor të këtij viti procesi i votimit në Kosovë do të organizohet nga organi i ri vendor për menaxhimin e zgjedhjeve, Sekretariati i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (SKQZ). Ky organ përbën pjesën operacionale të autoritetit zgjedhor, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ka një përbërje multietnike, financohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës dhe është organ jopolitik.

SKQZ-ja është e pëfaqësuar në të gjitha 30 komunat përmes nëpunësve në terren, zyrtarëve Ekzekutiv Komunal (ZEK). ZEK-të do ta kryesojnë dhe bashkërendisin Komisionin e Zgjedhjeve Komunale dhe do të kenë përkrahje nga Kuvendet Komunale sa i përket logjistikës, kuadrit, depove dhe transportit, që të jenë në gjendje të udhëheqin procesin e zgjedhjeve në komunat përkatëse. Në nivelin qendror, SKQZ-të bashkëpunojnë ngushtë me Institutin e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ), përfshirë edhe Ministrinë e Shërbimeve Publike, Arsimit dhe Financave si dhe me Zyrën e Kryeministrit (ZKM). Tashmë janë krijuar kontaktet dhe prandaj, ekziston një raport i mirë pune me IPVQ-të.

Departamenti i Zgjedhjeve i OSBE-së vazhdon me mandatin e saj për zhvillim të institucioneve për përkrahjen e procesit përmes ofrimit të trajnimit, këshillimit dhe monitorimit, por Departamenti i ka detyrat e veta përfshirë programin e votimit jashtë-Kosovës, regjistrimin e partive politike dhe numërimin e votave dhe dorëzimin e rezultateve.

Faza e parë e programit votimit përmes postës filloi më 17 qershor dhe do të vazhdojë deri më

10 gusht- azhurnimi i listës së votuesve dhe procesi i regjistrimit të ri për personat me qëndrim të përkohshëm jashtë Kosovës. Kështu, janë duke u kontaktuar personat me të drejtë vote, të regjistruar në zgjedhjet e kaluara, me qëllim të rikonfirmimit të statusit të tyre dhe të aplikimit për të votuar. Votuesve të rinj u jipet shansi për të aplikuar për fletëvotim. Për herë të parë votuesit e regjistruar në Kosovë, që do të jenë jashtë Kosovës në ditën e zgjedhjeve, meqë janë duke qëndruar përkohësisht jashtë Kosovës, do t'u bëhet e mundur që të aplikojnë për të votuar përmes postës. Të gjitha votat e grumbulluara jashtë Kosovës do të kthehen në Kosovë për numërim. Aktualisht është duke u realizuar një fushatë e gjerë e informimit publik për të përkrahur këtë program dhe janë krijuar faqe të internetit për ofrimin e informatave shtesë krahas ofrimit të qasjes në fletëaplikacion. Ekzistojnë disa linja telefonike në dispozicion të votuesve me qëllim që t'u ofrojnë ndihmë atyre rreth programit përmes postës.

Procesi i certifikimit të subjekteve politike përfundoi më 24 qershor. Të gjitha subjektet politike që dëshirojnë të jenë në fletëvotimet për Zgjedhjet e Kuvendit të Kosovës 2004 duhet të certifikohen. Veç kësaj, partitë politike duhet t'i jenë nënshtruar edhe procesit të regjistrimit.

Fundi i qershorit shënon fillimin e punës së shërbimeve të votuesve në Kosovë. Pjesa më e madhe e personave me të drejtë vote janë regjistruar gjatë zgjedhjeve të kaluara. Ata persona të cilët janë regjistruar që nga zgjedhjet e vitit 2002 do të informohen mbi vendvotimin e tyre përmes postës. Regjistruesit e rinj civil ose ata që dëshirojnë t'i përmirësojnë shënimet e tyre të regjistrimit civil mund ta bëjnë këtë në qendrat komunale të Shënimeve Civile. Ndihmë shtesë mund të sigurohet



duke vizituar Zyret Komunale të Zgjedhjeve në secilën komunë. Periudha e shërbimit të votuesve skadon në fillim të gushtit.

Shorti i fletëvotimeve do të hidhet në fillim të gushtit për të përcaktuar renditjen e subjekteve politike në fletëvotim. Kah fundi i gushtit deri në mes të shtatorit votuesit do të mund të "kundërshtojnë" listën provuese të votuesve. Kjo është një mënyrë e domosdoshme dhe transparente e sigurimit të saktësisë së listës së votuesve. Fushata parazgjedhore do të zhvillohet diku një muaj para zgjedhjeve, duke ua bërë të mundur subjekteve politike sigurimin e përkrahjes nga votuesit. Procesi i zgjedhjeve do t'i marrë parasysh edhe nevojat e votuesve, të cilët edhe më parë kanë qenë të përfshirë në programin e votimit të parakohshëm.

Njëherësh do të ketë një mekanizëm të ankesave dhe të mbikëqyrjes. Ashtu sikurse edhe në zgjedhjet e mëparshme, secili person që dëshiron të ankohet për çfarëdo aspekti të ecurisë së zgjedhjeve mund ta bëjë këtë përmes Komisionit Zgjedhor të Ankesave dhe Lutjeve (KZAL). Këshilli i Evropës edhe kësaj rradhe do ta dërgojë Misionin Vëzhgues

të Zgjedhjeve gjatë periudhës zgjedhore. Po ashtu, vëzhguesve vendorë, pas akreditimit, do t'u lejohet vëzhgimi i aktiviteteve.

Ekzistojnë, krahas procesit teknik të cekur më lartë, edhe një sërë parimesh udhëzuese në përputhje me situatën në Kosovë, të cilat duhet të respektohen gjatë procesit zgjedhor. Standardi i parë në programin "Standardet për Kosovën" ka të bëjë me procesin e zgjedhjeve. Në përgjithësi standardet kërkojnë zgjedhje gjithëpërfshirëse të cilat janë të lira, të drejta dhe të cilat çojnë drejt rezultateve të pranueshme.

Për të gjitha pyetjet mbi zgjedhjet parlamentare, ju lutemi vizitoni faqet vijuese të internetit:
www.zgjedhjetekosoves.org,
www.kosovskiiizbori.org, dhe
www.kosovoelections.org

Për çfarëdo informata shtesë, ju lutemi kontaktoni Zyrtarin e Lartë të Informimit të Sekretariatit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Teuta Troshupa, në teuta.troshupa@cec-ko.org ose Zyrtarin për Informim të Departamentit të Zgjedhjeve të OSBE-së, Karin Marmsoler, në Karin.Marmsoler@osce.org

Studentët e Universitetit të Prishtinës mësojnë për procesin legjislativ të Kosovës

Nga Fatmir Berisha, student në Fakultetin Juridik

Përveç lëndëve të shumta që ligjërohen në Fakultetin Juridik të Universiteti të Prishtinës, që janë të ndërlidhura ngushtë me funksionimin e parlamenteve, studentët e këtij fakulteti patën kënaqësinë që personalisht ta vëzhgojnë punën e Kuvendit të Kosovës. Meqë studentët tanimë kanë fituar ca njohuri teorike për funksionimin e Kuvendit përmes lëndëve Teoria Parlamentare, Hyrje në Administratën Publike, Ligji i Përkohshëm i Kosovës si dhe Ligji Kushtetues, ata tani me ndihmën dhe mirëkuptimin e Departamentit të Shkenca Politike të këtij Universiteti, Departamentit të Demokrazizimit të Misionit të OSBE-së në Kosovë (OMiK DD), Iniciativës së Përkrahjes së Kuvendit (ASI) dhe Sekretariatit të Kuvendit të Kosovës patën kënaqësinë që të ndjekin për së afërmi procesin ligjvënës në Kosovë.

Kështu, pesëmbëdhjetë studentë të drejtësisë, nga marsi deri në qershor, morrën pjesë në secilën seancë të Kuvendit. Gjithsej 90 studentë morrën pjesë në seancat e Kuvendit. Pos kësaj, është planifikuar që kjo iniciativë të vazhdojë edhe për një kohë, duke filluar që nga semestri tjetër, pas provimeve dhe zgjedhjeve të vjeshtës.

Përveç procesit të ligjvënies, studentët patën rastin që të njihem edhe me mënyrën e funksionimit të Sekretariatit të Kuvendit. Me këtë rast, Daut Beqiri, Drejtor i Departamentit Ligjor, Sali Rexhepi, Kryesues i Zyrës për Çështje Plenare dhe Procedurale dhe Sherif Konjufca, Kryesues i Zyrës për Media dhe Publikime, i informuan studentët mbi procedurat, të cilat zbatohen gjatë procesit legjislativ të Kuvendit të Kosovës. Njëherazi, studentët patën mundësinë që të shtrojnë pyetje stafit të Sekretariatit mbi të gjitha çështjet që u interesonin.

Personalisht dëshiroj të shpreh mirënjohjen time të thellë në emër të Fakultetit Juridik dhe të gjithë studentëve të cilët morrën pjesë në programin e ekipeve të OMiK DD-së dhe ASI-it, si dhe Sekretariatit të Kuvendit të Kosovës, që na bënë të mundur ndjekjen nga afër të seancave dhe njëherazi të mësojmë më tepër për aktivitetet në mbështetje të procesit legjislativ. Në veçanti, dëshiroj të falenderoj znj. Dhurata Abdiun (OMiK DD) e cila ofroi ndihmë të pakursyer për studentët gjatë gjithë implementimit të projektit.

Qasja përmes internetit në modelet dhe kornizat për punën legjislative



Legislationline.org është një shërbim falas përmes internetit i ofruar nga Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR) të OSBE-së, me përkrahjen e Bashkimit Evropian si dhe qeverive të Austrisë dhe Norvegjisë.

Legislationline.org përmbanë legjislacione shtetërore dhe dokumente tjera nga shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së (55 shtete në Kaukaz, Azi Qendrore, Evropë dhe Amerikë të Veriut) si dhe instrumente ndërkombëtare të ndërlidhura me mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit.

Qëllimi parësor i kësaj baze të shënimeve është ofrimi për ligjvënësit i modeleve dhe kornizave për punën e tyre legjislative dhe ndihma në përpjekjet e tyre drejt harmonizimit të standardeve vendore ligjore me obligimet e tyre shtetërore sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut. Legislationline.org në rradhë të parë është paraparë si mjet për ligjvënësit, jo për shrytëzuesit e ligjit. Nga kjo faqe, ata të cilët përgatisin dhe hartojnë norma ligje mund të sigurojnë mundësi nga legjislacionet e shteteve tjera të cilat mund tu ndihmojnë në vendimet e tyre. Faqja është e organizuar në përputhje me mundësi të shikimit të informatave të shpejta krahasuese (duke ofruar ekstrakte dhe duke pasur qasje në shënime përmes fjalëve më specifike kyçe) për dallim nga faqet tjera që ofrojnë listat e ligjeve të ndara nëpër kategori siaps fushave konvencionale të ligjeve.

Ekzistojnë katër mënyra të qasjes nga faqja kryesore dhe kombinime të ndryshme përgjatë tërë faqeve pasuese. Mund të zgjedhni një temë të veçantë (nga menuja kryesore), një shtet (nga menuja nën menynë tematike), një organizatë ndërkombëtare (nga menuja e "standardeve ndërkombëtare" në fund të faqes, në pjesën e majtë) ose dokument nga menyja e BE/KE (në fund të faqes, në pjesën e djathtë). Një karakteristikë kyçe është mundësia për shfrytëzuesit të filtrojnë kërkimin e tyre duke shtypur në më shumë çështje specifike nga menuat tematike që shihet nën secilën nënfaqe tematike. Kjo poashtu mund të kombinohet në shumë mënyra me mënyrat tjera të kërkimit të cekura më lartë, duke i mundësuar shfrytëzuesve krahasimin dhe shikimin e asaj që atyre i nevojitet gjatë punës së tyre. Legislationline nuk është një mjet kërkimi, i cili kërkon nëpër internet për informata relevante mbi ligjin, por është një bankë e pavarur shënimesh. Sipas regullit, të gjitha shënimet janë të paraqitura në cilëndo nga gjashtë gjuhët zyrtare të OSBE-së (anglisht, frengjisht, gjermanisht, italisht, rusisht, spanjollisht). Me gjithatë shumica e teksteve në dispozicion në këtë faqe janë në anglisht dhe më pak në rusisht.

Një shërbim i lajmeve ofron titujt kryesorë ditorë mbi ngjarjet kryesore ligjore në tërë rajonin e OSBE-së (kushtetutat ose amandamentet e reja në tekstet kushtetuese, e drejta sipas praktikës së mëparshme vendore dhe ndërkombëtare, marrëveshjet e reja ose dokumentet e tjera të rëndësishme, nënshkrimet/ratifikimet, miratimi i ligjeve dhe normave tjera të rëndësishme legjislative). Ky shërbim i lajmeve është në dispozicion në faqen kryesore. Të gjitha temat e reja me pjesët shtesë përgatiten në një buletin mujor të ofruar listës së abonentëve. Ky shërbim është falas. Shfrytëzuesit mund të abonohen përmes postës elektronike legislationline@odhr.pl. Qasja në faqen e internetit është <http://www.legislationline.org/>

Deklarata e Misionit të ASI-t

Si koordinatore e programeve për demokratizim për agjensitë që përkrahin Kuvendin e Kosovës, Iniciativa për Përkrahjen e Kuvendit (ASI) synon që ta forcojë dhe profesionalizojë Kuvendin e Kosovës në zhvillimin e aftësive në mënyrë që sa më parë të shndërrohet në një Kuvend stabil, funksional dhe efikas, i cili në vepron në përputhje me sundimin e ligjit dhe në mënyrë të barabartë në emër të të gjitha bashkësive dhe qytetarëve.

Anëtarët e iniciativës do të punojnë për t'i përqëndruar forcat e përbashkëta rreth një qëllimi të përbashkët që do të mundësojë përparimin në drejtim të arritjes së këtij pikësynimi. Puna e ASI-it do të përqëndrohet në kulturën politike demokratike duke u mbështetur në njohuritë dhe respektimin e rregullave demokratike të procedurës, transparencën dhe përgjegjësinë ndaj popullit, në zbatimin e rendit legjislativ, mbikëqyrjen e ekzekutivit dhe në respektin ndaj shumëgjyhësisë në Kuvend.

Si një koordinatore në mes të agjensive që përkrahin Kuvendin e Kosovës, ASI përkrahë Kuvendin përmes konferencave dhe trajnimeve, seminareve me komisioneve, ndihmës teknike për Kryesinë, për krerët e komisioneve dhe për delegatët e Kuvendit, përmes vizitave të bëra parlamenteve të vendeve të ndryshme, trajnimeve për personelin legjislativ dhe për përthyesit e Kuvendit. Përpos kësaj, edhe puna e këshilltarëve të Kuvendit dhe komisioneve të tij është pjesë e koordinimit të ASI-t.

Pjesëmarrësit e tanishëm të ASI-t:

Këshilli për Mbrojtjen e Drejtave dhe Lirive të Njeriut - KMDLNJ, Fondacioni Friedrich Ebert Stiftung (FES), Fondacioni Friedrich Naumann Stiftung (FNS), Konrad Adenauer Stiftung, Projekti për Praktikën Parlamentare Lindje-Perëndim (Holandë), Agjensioni Evropian për Rindërtim (AER), Agjensioni SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Kombëtarë Demokratik (NDI), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Departamenti i Demokratizimit i OSBE-së dhe Sekretariati i Kuvendit me përkrahjen aktive të zyrës së Kryeministrit, të zyrave të shtyllës së IV të UNMIK-ut UE-së dhe të zyrave përfaqësuese në Prishtinë, siç janë: zyra e Austrisë, Belgjikës, Gjermanisë, Italisë, Holandës, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.



<http://www.kuvendikosoves.org>

<http://www.skupstinakosova.org>

<http://www.assemblyofkosovo.org>

Fotografite nga: Lumni Rama (OSBE): kopertina dhe faqet 4, 5, 10, 13, 14, 17, 18; OSBE: faqet 7, 22, 24; UNMIK: faqja 4, web-faqja e Zyres së Kryeministrit: faqet 8, 9; Zyra Holandeze e Ndërlidhjes ë Prishtinë: faqe 11; Ulrich Steinle (OSBE) faqe 12; Fondacioni Friedrich Nauman (FNSt): faqe 19; B92: faqe 21, ODIHR: faqe 23. Atdhe Mulla: faqe 24.

Buletini informativ ASI dëshiron t'i falenderojë të gjithë ata që kontribuan si dhe Sven Lindholmin, njësinë e përkthimeve të DD pranë Misionit të OSBE-së në Kosovë, Lumni Ramën dhe Atdhe Mullën sepse pa përkrahjen e tyre ky Buletin informativ nuk do të ishte në dispozicionin tuaj.

ASI
NEWSLETTER

Rruga Beogradi 32, 38000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188

kontakt: franklin.devrieze@osce.org
<http://www.osce.org/kosovo>

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetëm atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikëpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t